

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVII i botimit, nr. 201, Korrik 2020

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

LAVDIA U TAKON ATYRE QË NUK SHKOJNË NË KUVEND, APO NË LUFTË ME DY MENDJE


2

Kaluan 105 vjet, që nga 15 korriku i vitit 1915. Ai nuk ishte një muaj si të tjerët për malësorët dukagjinasi e veçanërisht të Plan-Gjurajve. 15 korrikun, populli i Dukagjinit e përkujton si përballjen e madhe të tij kundër ushtrisë së rregullt dhe me plot armatime të Malit të Zi në vitin 1915. Dukagjini i dha kësaj qëndrese heroike 106 dëshmorë, nga të cilët, 81 dhanë jetën në Plan e Gjuraj.

Për numrin e popullsisë e sipërfaqen e territorit dhe hapsirën kohore, ku ishte teatri i luftimeve, mund të thuhet, pa frikë, se ishte nga gjakderdhjet më të mëdha në historinë e Shqipërisë, pse jo edhe shumë më gjerë. Për ato dora e një poeti shkroi:

*"...O i miri Plan, ç'të kanë parë sytë,
Kudo gjak, tym, flakë e të vrarë,
Edhe pse kanë kaluar 100 vjet,
Lotët dhe gjaku s'janë tharë..."*

Dukagjini është krenar për të parët e tij për luftën ,qendresen jetët dhe gjakun që dhanë për Dukagjinit, Shkodrën dhe Shqipërinë. Gjaku i atyre që bien në fushën e nderit për liri, "...Do të bien dielli e ska me e tha,/ Do të bien shiu e ska me e la..."



QËNDRESA POPULLORE E KODRËS SË PALÇIT DHE QAFËS SË AGRIT, KUNDËR EKSPEDITËS NDËSHKIMORE TË TURGUT PASHËS, KORRIK 1910

Nga Dodë Progni

3

Pas qëndresës heroike të luftëtarëve të Kosovës të udhëhequr nga Idriz Seferi, Isa Boletini dhe Hasan Hysen Budakova në Kaçanik, Caralevë e Budakovë, në prill 1910, kundër forcave të ushtrisë osmane, këto të fundit, me 12 qershor 1910, filluan operacionin në prenim të Rrafshit të Dukagjinit. Duke pas parasyshë qëndresën e fortë që Malësia e Gjakovës i kish bërë një vit më parë ekspeditës së Xhavit Pashës në Qafën e Morinës, në krye të divizionit të dytë që do të sulmonte Malësinë u vu vetë gjenerali më i shquar turk Shefqet Turgut Pasha, i cili u nis nga Gjakova për t'i ra Malësisë.

Pulti n`Feste, Festa e Qereshit

Ngjarjet e ndodhura ato ditë të korrikut 1915 janë të ruajtur dhe rrënjësura thellë në mendjen e popullit të Plan-Gjurajve dhe Dukagjinit. Ndonëse kujtime të trashëguara nga të parët, këta banorë nuk mundë të harrojnë luftimet e ashpëra, dhunën barbare të okupatorit malazez mbi banorët e fshatrave Plan-Gjuraj. Nga gjithë Dukagjini janë plot 106 të rënë, prej tyre 81 të rënë në mënyrë heroike në Plan dhe vetem nga fshatrat Plan-Gjuraj 75 luftëtarë, që dhanë jetën në mbrojtje të atdheut, në mbrojtje të lirisë. Sot, 81 dëshmorët kujtohen dhe emrat e tyre janë të skalitur në lapidarë dhe në bryqin e ngritur dhe restauruar, në vëndin e gjakëderdhjes më të madhe të kesaj "Qeresh". Kjo ngjarje historike përkujtohet çdo vit që nga që nga data 15 korrik 1910.

6



LAVDIA U TAKON ATYRE QË NUK SHKOJNË NË KUVEND, APO NË LUFTË ME DY MENDJE



Luigj Shyti

Kaluan 105 vjet, që nga 15 korriku i vitit 1915. Ai nuk ishte një muaj si të tjerët për malësorët dukagjinase e veçanërisht të Plan-Gjurajve. 15 korrikun, populli i Dukagjinit e përkujton si përballjen e madhe të tij kundër ushtrisë së rregullt

dhe me plot armatime të Malit të Zi në vitin 1915. Dukagjini i dha kësaj qëndrese heroike 106 dëshmorë, nga të cilët, 81 dhanë jetën në Plan e Gjuraj.

Për numrin e popullsisë e sipërfaqen e territorit dhe hapsirën kohore, ku ishte teatri i luftimeve, mund të thuhet, pa frikë, se ishte nga gjakderdhjet më të mëdha në historinë e Shqipërisë, pse jo edhe shumë më gjerë. Për ato dora e një poeti shkroi:

*“...O i miri Plan, ç’ të kanë parë sytë,
Kudo gjak, tym, flakë e të vrarë,
Edhe pse kanë kaluar 100 vjet,
Lotët dhe gjaku s’janë tharë...”*

Dukagjini është krenar për të parët e tij për luftën ,qendresen jetët dhe gjakun që dhanë për Dukagjinin, Shkodrën dhe Shqipërinë. Gjakun i atyre që bien në fushën e nderit për liri, “...Do të bien dielli e ska me e tha./ Do të bien shiu e ska me e la...”

Kështu ndodhi edhe më gjakun e të rënëve në ato ditë të stuhishme, i cili nuk është “tharë”, e as nuk është “larë” edhe pse kanë kaluar 105. Njerizit vdesin kur harrohen.

Të tillë do të mbeten gjithmonë Mehmet Shpendi së bashku me trimat e trimëneshat dukagjinase që dhanë jetën në Malet e Planit e në Dukagjin në atë verë të nxehtë nga dielli i korrikut por më shumë nga flaka e pushkëve vrasare të pushtuesve e nga zjarri i shtëpive të djegura. Njeriu edhe mund të bie, por i lumtur është ai që ngrihet përsëri.


Ata që kanë dhënë dhe japin jetën për lirin e përparimin e vendit të vet ngjiten në piedestalin e historisë për të mos u harruar kurrë. Të tillë janë dhe do të mbeten të gjithë ata burra e gra nga Dukagjini që u bënë flakadan për tu ndriçuar në shekuj rrugën brezave.

Gjaku i Mehmet Shpendit dhe trimave e trimëreshave që vdiqën bashkë, nën breshëritë e barbare të pushkëve armike, rrodhi së bashku me ujin e pastër të lumit Kir dhe ja ku mbiu, këtu po buzë Kirit, kjo përmendore e pavdekshme, në gjirin e Shkodrës mikpritëse, në Shkodrën e historisë dhe kulturës së lashtë dhe të re. Shoqata “Atdhetare “Dukagjini”,

kryesia dhe dashamirësit e saj dhe të Dukagjinit, u bashkuan në një mendje guxam, po guxam, dhe ja dolëm. Kjo këmbëngulje, kjo vendosmëri, ky bashkëpunim dhe kjo mbështetje e gjerë, bëri të mundur që sot të jemi këtu, nën “hijen” e shtatores së atdhetarit Mehmet Shpendi. E poeti vazhdoi:

*“...Përpara shtatores tënde,
Qëndroj plot krenari,
Faleminderit, o Mehmet Shpendi,
O gurë themeli në histori...”*

Kjo përmendore historike e Mehmet Shpendit, për veprën e tij heroike, flet shumë për të shkuarën tonë, këshillon për të sotmen dhe hedhë vështrimin drejt të ardhmes. Mehmet Shpendi, jeta e tij dhe bashkëluftëtarëve të tij, të mishëruara në këtë shtatore, ishin në një kohë kur nuk ishim ne, por, që ne të ishim sot. Nderi dhe lavdia u takon atyre që nuk shkojnë në kuvende apo frontin e luftës me dy



mendje.

Pesë vite më parë u ngrit shtatorja e Mehmet Shpendit në qytetin e Shkodrës. Është

kontribut i shumë njerëzve që banojnë në Shqipëri dhe në shumë vende të botës, që nga Miçigani, Nju-Jorku, Belgjika, Italia, Anglia, Greqia, Tirana, Shkodra 192 kontribuesve dukagjinase e dashamirë

të Dukagjinit, në krye të cilëve qëndron bashkësia dukagjinase në Nju-Jork, nën organizimin e grupit të punës në krye të cilit zgjodhën zotin Tom Balbona, të cilët siguruar 52 % të vlerës së përgjithshme për ngritjen e shtatoreve të Mehmet Shpendit dhe Martin Camajt. Por edhe kontribues nga Shqipëria dhanë një ndihmesë mjaft të rëndësishme që kapim vlera milonshë nga secili si Prenda Mark Shpendi, Kolë Çardaku e Martin Bardhoj Martini, Është me vend të përmendim e vlerësojmë edhe ndihmesën e drejtuesve të Bashkisë Shkodër, të kohës, që na ndihmuan dhe qëndruan afër me mendime, këshillime e me veprime konkrete, pa të cilën do të ishte pamundur vendosja e tyre aty ku janë sot.

Sa shpejt kaluan pesë vjet, e shtatorja e Mehmet Shpendit na vështron nga

pjedestali i historisë, janë rritur pemët dekorative, nuk ka papasterti, është shtuar gjelbërimi, por më kryesorja mendoj se është rritur akoma më shumë imazhi i Mehmet Shpendit, është vlerësuar më shumë puna e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, etj. Shtatorja e Mehmet Shpendit ju flet përditë bijëve dhe bijave dukagjinase, u jep pororsi e këshilla, me veprën e tij të pavdekshme.

Shtatorja e Mehmet Shpendit, që nga dita kur u vendos në atë piedestal, duket sikur i flet brezit të rinj dukagjinase, e brezave që vinë, por edhe shumë më gjerë: “Mos na turpëroni, mos u tërhiqni para vështirësive, jetoni me djersën tuaj dhe shmanguni veseve të dëmshme të së kaluarës, por dhe atyre që koha që po jetojmë na i ka vënë përballë. Mbajeni kokën lart për brezat që kanë kaluar, sepse askush nuk mund tua zënë kryet për ne e të parët tonë”. Është e domosdoshme që të gërshetohen vlerat e së kaluarës me ato vlera të sotme që i shërbejnë njeriut, familjes e shoqërisë. Po, është koha e kalemit dhe librit, dhe jo e e zërit të lartë, grindjeve e ngatresave për hiçgjë, është koha e ligjit bashkëkohor, e kulturës dhe e arsyes dhe jo e grykëhollës.

Mehmet Shpendi, rrjell nga fisi kryengritës i Shalës, i lindur në Pecaj të ketij fisi, në vitin 1851, aty ky fjala, puna e pushka ishin bashkëlidhur në mënyrë të pazgjidhshme, aty ka ndahet kuvendi, aty ku merr rrugë besa, burrnia e urtia, aty ku ka prijës të përzgjedhur, të fortë për pushkë e të urtë për fjalë. Mehmet Shpendi, me mendjen dhe punën e tij fitoi respektin në të gjithë krahinën e Dukagjinit. Burri heroik i Shalës, u shqua në shumë luftëra për trimëri dhe qëndresë të vendosur Kombëtare, duke

mos pushuar së luftuari për liri dhe Atdhe deri se plumbat e tradhëtisë e përshkuan duarlidhur dhe në besë në Ndërkisa të Planit me 15 korrik 1915. Edhe në momentet e fundit i dërgoi lajimin Shalës që të mos dorëzohej duke luajtur gishtin e pushkës për nën gu, e duke lënë fjalët lapidar “tokë e qiell paça lanë dorëzane, kurrë anmikut besë

QËNDRESA POPULLORE E KODRËS SË PALÇIT DHE QAFËS SË AGRIT, KUNDËR EKSPEDITËS NDËSHKËMORË TË TURGÛT PASHËS, KORRIK 1910

Nga Dodë Progni

Pas qëndresës heroike të luftëtarve të Kosovës të udhëhequr nga Idriz Seferi, Isa Boletini dhe Hasan Hysen Budakova në Kaçanik, Caralevë e Budakovë, në prill 1910, kundër forcave të ushtrisë osmane, këto të fundit, me 12 qershor 1910, filluan operacionin në prenim të Rrafshit të Dukagjinit. Duke pas parasyshë qëndresën e fortë që Malësia e Gjakovës i kish bërë një vit më parë ekspeditës së Xhavit Pashës në Qafën e Morinës, në krye të divizionit të dytë që do të sulmonte Malësinë u vu vetë gjenerali më i shquar turk Shefqet Turgut Pasha, i cili u nis nga Gjakova për t'i ra Malësisë.

Plani i komandës xhonturke ishte, që operacionin të kryhej në drejtim të Qafës së Morinës–Qafës së Kolçit–Qafës së Agrit–drejt Shkodrës, ku do të vepronin 18 batalione këmbësorie dhe disa skuadronë kavalerie të përforcuara me bateri artilerie. Ndërkohë, rreth 2000 malësorë nga Gashi e Krasniqja të mobilizuar nën kushtimin tradicional dhe të prirë nga prijësit e njohur popullor Zeqir Halili, Sadri Bardhi, Halil Brahimi, Abdulla Hoxha e të tjerë. zun pritrat në frontin e Qafës së Morinës për të mos lejuar ushtrinë turke të hynte në Malësi.

Turgut Pasha, ashtu si paraardhësi i tij Xhavit Pa-

sha, përdori metodat më të egra shnjerezore për të nenshtruar vendin. Përveç qindra goditjeve me artileri, ai dogji e shkatërroi pothuaj të gjitha shtëpitë e krahinës së Gashit. Në këto luftime të përgjakshme dhe heroike u vranë dhe u plagosën shumë luftëtarë malësor. Forcat operative osmane duke pas epërsi të theksuar ushtarake në numër dhe armatime arritën të hyn në Gash, Krasniqe dhe Bytyç, duke bërë të mundur edhe vendosjen e administratës xhonturke në Malësi. Këto forca pushtuese së bashku me shtabin e tyre drejtues u përqëndruan në livadhin e Fangut të Mulosmanaje, i njohur më pas si “Livadhi i Turkut”, dhe prej aty ushtria sulmonte pa ndërprerje fshatërat, rrëzonte kullat, grabiste bagëtitë dhe kapte e arrestonte kryengritësit, të cilët pasi i turronte i dënontë me burgim. Ata filluan menjëherë çarmatimin e kryengritësve, rregjistrimin e popullsisë e të pasurisë, mbi bazën e të cilit do të vilesnin taksat. Të gjithë burrat nga 16 deri në 60 vjeç u rregjistruan për t'i mobilizuar si rekrut në ushtrinë turke. Njerëzit, veçanarisht të rinjtë, kapeshin nepër shtëpi, dërgoheshin në vendin e tubimit, pastaj transportoheshin drejt Selanikut dhe vendeve tjera të Azisë për të krye sherbimin ushtarak për hesap të turqisë. Për t'u shpëtuar këtyre raprezaljeve: çarmatimin, rekrutimit për në ushtri, rregjistrimit të tokave

e bagëtisë dhe pagimit të taksave shumë banorë të Gashit e të Krasniqes qenë detyruar të dalin malit dhe të organizojnë grupe kaçakësh, të cilët herë pas here sulmonin forcat turke. Nga masat që mori qeveria xhonturke me këtë rast kundër shqiptarëve në Kosovë e Malësi. çarmatimi i përgjithshëm ishte masa më e rëndë që bëri përshtypje të thellë në popull. Kjo masë u hiqte shqiptarëve mjetin më të efektshëm, jo vetëm për t'i rezistuar politikës shtypëse e arbitrare xhonturke, por edhe për të mbrojtur vendin nga grabitëqarët shovinistë serbo-malazezë.

Në vijim të planit të tyre për nënshtimin e plotë të “malësive të pabindura” forcat turke bënë organizimin për të sulmuar Nikaj–Merturin e Dukagjinit. Ndërkohë malësorët e Nikaj–Merturit që ndiqnin me vëmendje ngjarjet e zhvilluara në Kosovë, Gash e Krasniqe, terrorin dhe mizoritë e pashembullta që forcat turke kishin ushtruar kundër popullsisë që organizoi rezistencën heroike në Caralevë, Kaçanik, Rrafshin e Dukagjinit, Qafën e Morinës, Gash, Krasniqe, Bytyç e kudo gjetkë, e shifnin çdo orë e më të afërt mundësinë e ndëshjes me atë furtunë shkatërruese që kish vendosur të nënshtroi shqiptarët. Për t'i bërë ball asaj, në fund të qershorit 1910, rreth 200 burra të Nikaj–Merturit u mblodhën në kuvend tëk Kodra e Bek Selimit–Lekbibaj. ►

mos me i zanë”.

Mehmet Shpendi është figurë unikalë historike e krahinës së Dukagjinit e paparlyer gjatë gjithë jetës së tij. U deshën njëqind vjet për të vlerësuar punën dhe veprimtarinë e këtij gjeneralit të maleve, dhe për ta vendosur në vendin e merituar që ka sot.

Mehmet Shpendi jetoj 64 vjet, prej të cilave 42 vjet është me pushkë në dorë, e përfaqë, në shërbim të vendit të tij, çështjes shqiptare, për liri e pavarësi. Ai është përfaqësues tipik i vegjëlisë, pa privilegje personale dhe familjare, arriti të bëhet simbol për brezat në ndërgjegjen atdhetare, si prijës i Djelmnisë së Shalës e Dukagjinit, si drejtues i betejave të stuhishme, si dijetar i kuvendit, si pleqnues i drejtë sipas të Drejtës Zakonore të kohës e si zbatues i saj, si një atdhetar me ndërgjegje të lartë kombëtare, i cili u flijua për idealin më të shtrenjtë, atë të atdheut.

Është kjo arsyeja që poeti Risto Siliqi në vitet e para të shekullit XX shkruante për Mehmet Shpendin:

*“Kurrë nuk gjindet zdashë e zdashun,
Por gjithmonë gatue për pritë,
N'zheg e n'shi e n'borë e breshun,
Shtati i tij gjithmonë vaditë ...”.*

“Djelmnia e Shalës”, nën drejtimin e Mehmet Shpendit, është unikalë për organizimin politiko-shoqëror-ushtarak të kohës. Ajo qëndroi stoike dhe e pazhigatur. Djelmnia u ndje si një forcë qeverisëse-ekzekutive në territorin e saj. Kjo nxitje që edhe krahina të tjera ta ndiqnin, të organizoheshin dhe të bashkëpunonin me të.

Duke gjykuar nga mendimet, të rejat që solli në jetën e krahinës, Djelmnia e Shalës, veprimet dhe

shikimin pozitiv drejt së ardhmes, pse jo edhe nga mosha, mund të thuhet pa drujtje se ajo që formacioni i parë rinor shqiptar me këtë nivel organizimi, me këtë largësi shikimi, me këtë thellësi mendimi. Franc Nopça e ka quajtur “Opozita e parë shqiptare”

“Mehmet Shpendi ka qenë dhe mbetet simboli i qëndresës popullore të Dukagjinit në udhëkryqet më delikate të historisë sonë nacionale”, shkruante Ndue Sanaj ato ditë që u vendos shtatorja.

Me vendosjen e shtatores së Mehmet Shpendit, qyteti i Shkodrës ka edhe një pikë tjetër orjentuese më shumë, shkruante Prelë Shytani ato ditë.

E Prelë Milani do të shkruante, “Mirë se erdhe o krushkamadhi i lirisë! Mirë se erdhe o vëlla se më kishte djegur malli me të pa! Mirë se erdhe në Shkodrën tonë Iliriane, se cilës ju bëre mburojë në kohët më vështira kur zbrapse pa lavdi Shefqet Turgut Pashën dhe Kostandin Nikiçin”.

Prenda Mark Shpendi është familjari më i afërt i Mehmet Shpendit që është gjallë sot. Nuk ka si të mos na kujtohet takimi dhe biseda e çiltër me të pak ditë pasi u përurua shtatorja e Mehmet Shpendit. Ajo me sy të përplotur, por dhe me ndjenjen e gëzimit që arriti të shohë kushuririn e saj, njëqind vjet pas vdekjes, të përjetësuar në bronx, duke vënë dorën në zemër, me zërin që i dridhej nga emocionet thotë prerë: “Dita më e gëzuar e jetës time ishte kur u ngrit shtatorja e Mehmetit dhe marrja e titullit “Nderi i Kombit”, e pasi qetësohet disi, thotë, “Kam 85 vjet jetë (sot ka 90 vjet), dhe asnjëherë nuk kam pasur gëzim më të madh se sa ditën që ju bënë këto nderime axhës së babës tëm, Mehmet Shpendit” e nga sytë i rollën pika loti”. Ajo nuk gjenë fjalë për të falënderuar të gjithë ata që menduan, organizuan, punuan e kontribuan në këtë drejtim, por vendosë dorën në zemër, sytë i drejton nga qielli dhe thotë:

“Zoti jua ditët, jua priftë mbarë, ju bekoftë e ju ndihmoftë”.

Përkujtimet, siç po bëjmë edhe sot, mbajnë ndezur pishtarin e historisë. Nepërmas kujtimeve të së kaluarës nxirren mësim për të sotmen dhe të ardhmen. Më kujtohen fjalët e të ndjerit Zef Gjeloš Ara, vite më parë, kur po përkujtonim këtë ngjarje në Qeresh. Kishim mbaruar çfarë kishim në program. Ishte një ceremoni e thjeshtë me një kurorë, e disa përshëndetje e kujtime. Ndërsa rrinim në një hije e dikush na solli nga shtëpia raki, djalthë e ndonjë gjë tjetër, në një moment qetësie, Zefi thotë: “Unë e disa të tjerë që jemi këtu jemi të vjetër, por kam një amanet veçanërisht për të rinjtë, në çdo 15 korrik, mos e leni pa dalë e me u takue me njëri tjetrin në këtë vend, u organizoi apo nuk u organizoi kush, sa me pi nga një cigare duhan apo një gotë raki, në kujtim të asaj kohe heroike”.

Dukagjini është taban pjellor, e në një taban të tillë gjithmonë ka pasur dhe ka për të pasur lindje e rritje të figurave që i shërbejnë krahinës dhe vendit me mend e me zemër. Prandaj pa asnjë dyshim mund të themi:

*“...Dukagjin, “Nderi i Kombit”,
Dukagjin, palca e gurit,
Dukagjin, rojtar i trollit,
Dukagjin, n'ngjyra t'flamurit...”*

Lavdi Mehmet Shpendit dhe të gjithë atyre që derdhën gjakun për Lirinë dhe mbrojtjen e trojeve tona, Atdheut, që na e lanë amanet të parët.

Luigj SHYTI
16 korrik 2020


◀ Inisiatorët e këtij kuvendi-Prelë Tuli e Man Avdia e të tjere. u përpoqën të bindin kuvendin që rezistencën kundër forcave të Turgut Pashës ta bënin së bashku dhe të përqëndruar në Qafën e Kolçit. Por kjo nuk u arrit. Shumë pjesëmarrës argumentuan se krahina nuk kishte forca që mundë të përballëshin me një ushtri moderne të asaj kohe siç ishte ajo e Turgut Pashës. Malësorët nuk kishin as minimumin e armëve të armikut. Në kushte të tilla, argumentuan ata, populli do të terrorizohej dhe e tërë krahina do të digjej e plaçkitesh, prandaj preferuan qëndresë të organizuar me luftë kaçakesh, me sulme të hërëpashërëshme dhe të befasishme. Por Man Avdi dhe Prelë Tuli kishin këmbëngul për një ndeshje të dretpërdrejtë me armikun, prandaj kur po largohej nga kuvendi ky i fundit kishte thënë: “Do të gjëndet një qafë tjetër ku turku ka për t’u ndesh me armët tona”. Lidhur me këtë këmbëngulje të Prelë Tulit, kronisti i asaj kohe Kamilio Libardi, do të shkruante: “Shkaktari e frymëzuesi i këtij qëndrimi armiqësor kundër qeverisë turke ishte Prelë Tuli i Salcës, një shqiptar i vërtetë nga origjina, nga fama e nga bëmat”. Ndërsa revista Hylli i Dritës 1937, kur përshkruan qëndresën e vitit 1910, duke shkruar: “Prelë Tuli, ai Leonidhë i maleve, doli përpara ushtrisë më të madhe të kohës me një grusht malësorësh”.

Pas kuvendit të Lekbibajt, një kuvend tjetër do të organizohej. Ai i fshatrave Salcë, Palç e Brisë, ku u lidh besa për qëndresë kundër forcave turke. Kuvendi zgjodhi shtabin drejtues të përbërë nga Prelë Tuli, Man Avdia, Sadik Gjergji e Deli Tahiri, të cilët do të udhëhiqnin luftën kundër një ushtrie të madhe të paisur me armët më moderne të kohës.

Kodra e Palçit do të ishte kryeprita që do tu bëhej forcave turke, dhe aty që kishte caktuar Prelë Tuli e Deli Tahiri me dhjetra burra të Salcës, të cilët do të mbronin vendin me çdo çmim. Më në jug do të vendosej Man Avdia e Sadik Gjergji me burrat e Palçit, ndërsa më në veri, në Kokdoç e Sukë të Mar Vatës do të zinin pritat burrat e Brisës. Gjithashtu u muarën masa për mbrojtjen e popullsisë, furnizimin e luftëtarve me ushqime e municion dhe vendosjen e lidhjeve me fiset tjera të Dukagjinit. Për këtë qëllim, tre ditë përpara se të niste lufta Prelë Tuli dhe Sadik Gjergji shkuan në Shalë tek kisha e Abatit, ku morën takim me Të parin e Djelmnisë së Shalës-Mehmet Shpendi, famulltain atdhetar Padër Çiril Cani dhe burra të tjerë të parisë si: Pepë Ndreun, Çun Nikën, Marash Delinë, Cukel Delinë, Mirash Ndoun e të tjerë. Këta, në emër të kësaj Dukagjinit deklaruan se Dukagjini do të organizonte qëndresë të armatosur në

kufij e tij. Pra, Kodra e Palçit dhe Qafa e Agrit do të ktheheshin në epiqendra të rezistencës së armatosur kundër forcave osmane. Ato do të bëheshin dy llogore të pakalueshme për ushtrinë pushtuese.

Me 5 korrik 1910, forcat operative të ushtrisë turke me në krye shtabin e tyre drejtues u nisën nga Livadhi i Bujanit drejt Nikaj-Merturit në dy drejtime: Grupi i parë në drejtim të Geghysenit e Qafës së Kolçit, dhe i dyti, në krye të të cilit qëndronte tradhëtari Ali Begu, në drejtimin Bujan-Rajë-Tetaj dhe Nikaj. Pas disa orë luftimesh të zhvilluara në Qafën e Kolçit, forcat turke nga të dy drejtimet arritën të depertojnë në krahinë dhe të vendosin shtabin e tyre në kishën e Nikajt, prej nga filluan operacionin e mbledhjes së armëve në fshatërat e Nikaj-Merturit. Në kuadrin e këtij op-




eracioni komanda turke thirri përfaqësuesit e fshatrave Palç, Salcë e Brisë, të cilëve do tu kërkonin dorëzimin e armëve dhe nenshtrimin ndaj kërkesave të forcave osmane. Ata, jo vetëm nuk u paraqitën, po dhe i dërguan fjalë komandës turke “Hajde merri armët!” Ky ishte një deklaramospërfillës e kërcënues që tregonte qartë se këto fshatëra kishin vendosur të mos i bindeshin urdhërave të komandës turke. Të indinjuar nga mosparaqitja e krerëve të tre fshatrave, forcat turke, me 10 korrik 1910, sulmuan Kodrën e Palçit. Që në përpjekjet e para në afërsi të Kodrës së Palçit, pararoja e armikut u ndesh në rezistencën e fortë të 70 luftëtarve malësor të prirë nga Prelë Tuli. Lidhur me këtë përpjekje, epika historike-kronikë kryesore e asaj kohe thotë: “Qaj Prelë Tuli trim i çartun, / Qet manxerre e vret bimbashin, / Zjerm i gjallë mbas tij djelmnia, / Trim i rrallë ky Man Avdia /...” Prej këtu armiku, pasi la disa të vranë, u detyrua të ndër-

roj drejtim dhe mori rrugën drejt Qafës së T’therme nga ku mundë të fuste më mirë në shënjestrën e artilerisë së vet fshatrat Salcë, Brisë dhe Qafën e Agrit. Luftëtarët popullor menjëherë zunë pritat në Kodër të Palçit dhe përqëndruan forcat kryesore tek Guri Murg, përballë Qafës së T’thermes, duke u prerë të gjitha rrugët dhe mundësitë e kalimit të forcave armike. Guri Murg, ku ishin mbërthyer fort, si shqipja pas shkëmbit, që për luftëtarët e Palçit, Salcës dhe Brisës u bë fortesë e pathyeshme për forcat armike. “Guri Fatal” e quajtën ata, pasi në këmbët e tij lan shumë të vranë e të plagosur. Armiku për disa ditë rresht ndërmori sulme të fuqishme kundër pozicioneve të luftëtarve popullorë. Ata goditën me forca të shumta e të përqëndruara të këmbësorisë dhe me artileri, por pa sukses. Sepse malësorët e njihnin mirë

dite ai kishte hedhur nga pozicioni i tij 37 gjyle”. Me piskamën kushtrimtare e vendosmëri shqiptari, malësorët mahnitën pashallarët turqë. Kënga popullore me një figuracion artistik mjaft të goditur thotë: “Pasha shkruen letra te mbreti: / Kurr s’kam pa ksi soj mileti! / Qes me top gjylen ma kap, / Qes me pushkë m’i hallakatë! / Mitralozit m’i thotë rrokaç /...”

Po cilët ishin ata prijës e luftëtar trim e guximtarë që ato ditë të nxehta të korrikut 1910, të mbërthyer në shkëmbajt e kësaj toke siç ishte Guri Murg, i kishin dalë ballë për ballë ushtrisë së fuqishme osmane që komandonte Turgut Pasha?! Ata ishin nikaj-merturës. Të gjithë banorët e fshatrave Brisë, Salcë dhe Palç. I madhe i vogël, që nga fëmijët dhe gratë e deri tek pleqtë. Burrat që ishin për pushkë i kishin rrokur ato dhe luftonin në Kodër të



terenin dhe ishin zotër të tij. Këta përdorën me mjeshtëri taktikën e kundërsulmit të shpejtë e të befasishtë, ditën dhe natën, në pika të ndryshme e me forca të pakta. Siç deklarorin vetë oficerët osmanë, kishin të bënin me një armik që duket në një pikë, sulmon, pastaj zhduket për të dal menjëherë në një pikë tjetër” Ndërsa një korespondent ushtarak i asaj kohe që shërbente në Stamboll shkruante ne revistën “Novaja Vremja” të Petërburgut për luftën e shqiptarve: “Luftojnë tue ndjekun një sistem të ri që, po të flasin troç, s’është më luftë e guerileve. Me një fjalë vihet rë se në mënyrën e tyre të të luftuarit ka diçka të re”.

Rezistencën heroike të malësorve-qëndrestarë e mbrojtës të lirisë nuk e thyen breshëritë e vijueshme të mitralozave, as gjylet e topave prej çeliku që u hodhën pa kursim mbi ta dhe kullat e tyre. Sipas dëshmisë së një ushtari turk, pasqyruar në kronikat e Kamilio Libardit, “vetëm gjatë një

Palçit dhe në Gurin Murg, ndërsa të tjerët: dikush silltë municion dhe ushqime luftëtarve, të tjerët bluanin dhe gatuanin e disa të tjerë mbronin bagëtitë nga grabitjet. Të pa harruar, me nder e lavdi jan skalitur në historinë e Nikaj-Merturit emrat e grave nga Palçi, Zojë Markja dhe Lulë Sylja, të cilat u kacafytën me ushtarët turqë e dhan jetën duke mbrojtur pragun e shtëpisë së tyre. Në ato luftime, që vazhduan disa ditë u derdh dhe gjak. Prelë Tuli mori plagë të rënda, Vat Luci, Sokol Toma, Çun Doda, Grime Ndou gjithashtu u plagosen gjatë përleshjeve me armiqët në vijën e parë të frontit. Ndërsa Vogël Muslia dha jetën duke mbrojtur shtëpitë e fshatit që të mos i djeg osmani.

Ndërsa, nga Kodra e Palçit e deri në T’therme të Nikajt e në Gurin Murg kërciste pushka, mitralozit dhe topi, nga Kunora, në Qafë të Agrit, të Nermajens, të Valbonës e deri në Qafën e Pejës kishin zënë pritat ▶

Shala, Shoshi, Toplana e gjithë Dukagjini. Me të kris pushka në Kodër të Palçit trimi i rradhe Mehmet Shpendi kishte lëshue kushtrimin në Shalë e Dukagjin: “O hiq kushtrim se ne ra turku!”. E si vetima ishin organizuar e mësy qafat më shumë se 1000 burra të armatosur. Epika historike e ka përcjell brez pas brezi këtë moment heroik me vargjet: “Mehmet Shpendi trim si motit! / Vrik piskati nepër fis, / N’kamë o djelm’ heu ndima e Zotit! / Se n’Mertur pushka u nis...”. Ndërsa revista “Hylli i Dritës”, 1937, do të përshkruante kështu gadishmerinë, shkathtësinë dhe shpejtësinë me të cilën Dukagjini ju përgjigj thirrjes së Atdheut, duke zënë qafat e duke i kthyer ato në qendresa të pakalueshme për ushtrinë turke: “Në atë bërë, në atë lidhje, - theksonte ajo - doli kush kje djalë për pushkë, e nisën me u shpërnda malit me pushkë e sopata, me shyetën e torrokopë, tuj këndue e tuj qit pushkë si të ishin tuj shkue në dasëm. Puna ma e par kje me zan shtigjet ndër qafa e lugje, me prishë rrugët, me pre e me rrëzue landë për me pengue kalimin, me çil hendeqe, gropa e llogore për me u mbrojtë prej plumbash t’anmikut”.

Atë ditë kushtrimi fisi i Shoshit kishte natën e Shqurkut, të cilën sipas traditës po e lusnin me miq e bija. Por me t’u ndigjue thirrja kushtrimtare: “O hiq se ra turku!” shoshjanët lan festën, morën pushkët dhe qirinjtë në gji dhe u nisën drejt qafave dhe maleve ku kishin vendin e tyre. Kënga popullore thotë: “Ka dal Shoshi shpi për shpi, / Tuj lut festë me mik e bijë, / Pushkën n’dorë qirat në gji, / Deli Marashi u ka pri, / N’qafë Kunorë kan dal shefi /...”.

përkatëse:

- Luftëtarët e Thethit, me në krye Prel Gjeloshin, Lekë Currin (Gjeçaj), Kolë Markun e Dush Perën (Fushë), Mar Kolën (Ndërlysa) do të ruanin ditë e natë Qafën e Pejës dhe të Valbonës;

- Luftëtarët e Pecaje, Abatit dhe Pjollit do të zinin Qafën e Ndërmajës ku do të ishin: Mehmet Shpendi, Prelë Marku, e Pepë Ndreu nga shtëpia e bajraktarit të Shalës, Çun Nika, Marash Delia e Shytan Nika (me Lekaj), Cukel Delia, Pal Vatush Leka e Mirash Vatë Leka (me Abat), Çun Kola (me Qukë), Prel Gjeloshi (me Pjoll);

- Qafën e Agrit do ta zinin Lulash Preka e Mirash Ndou (me Vuksanaj), Bejte Ndoci, Shytan Vuksani (me Lotaj), Binak Kola (me Dakaj), Syk Marku (me Nënnavriq), Çuk Delia dhe Avdi Kola me Gimaj dhe Plan;

- Shoshi dhe Toplana me prijësit e tyre: Gjelosh Kola (bajraktar), Deli Marashi (prijës), Babun Celi, Balë Gjoni, Mark Milani, Mëhill Nika, Zmal Preka, Shiqer Ndou, Qerim Ndou dhe Rrustem Lulashi, do të zinin Qafën e Kunorës dhe të Shtreziqes. Këtu do të përqendroheshin edhe luftëtarët e Dushmanit: Lulash Dema (vojvodë) me Papaj; Sokol Bala (me Vasaj) e Mirash Preka (me Kokaj). Kështu brenda 6 orëve luftëtarët nga i gjithë Dukagjini, të betuar se, “këtu turku nuk kalon!” kishin zënë çdo shteg e çdo qafë, nga Shtreziqja deri në Qafën e Pejës, duke formuar një front mbi 20 km të gjatë. Lidhur me këtë Padër Çiril Cani – famulltar i Shalës, me 14 korrik 1910, do t’i shkruante kolegut të tij në Shosh P. Kamilio Libardi: “Dje kam kenë në Qafë të Agrit... shaljanët e kan qit

çahej! Përball kishte Gurin Murg, atë fotesë të pathyeshme ku ishin mbërtuer luftëtarët e Salcës, Palçit e Brisë, të cilët sulmonin armikun pa pushim ditën e natën. Fronti tjetër në Qafë të Agrit e të Ndërmajës me të shtëna armësh, potërë e zjermnije të ndezura që shkulmonin flakët përpjetë i priste nga çasti në çast. E përveç këtyre, turqit po përballeshin nga dita në ditë edhe me një front tjetër mjaft të vështirë në prapavijat e tyre. Ata vërtetë kishin mundur të hynë në shum fshatra të Nikaj–Merturit, duke filluar nga Raja e deri ne Palç e Peraj. Kishin zaptuar kishën e Rajës, të Nikajt e të Palçit duke nxjerr përjashta famulltarët e kthye ato në gazerma dhe komanda ushtarake, kërkonin çdo ditë çarmatimin e popullsisë, sulmonin kullat e bagëtitë duke grabitur e plaçkitur çfarë mundënin e ku mundnin, por malësorët e këtyre fshatrave nuk ishin nënshtruar. Ata krijuan grupe kaçakësh, të cilat u vunë në mbrojtje të popullsisë dhe të pasurisë duke sulmuar here pas here forcat turke. Objekt i sulmeve të këtyre grupeve, në mënyrë të veçantë, ishin karvanet që vinin me ndihma nga Gjakova dhe Krasniqja nepërmjet rrugës së Qafës së Kolçit, të cilat sillnin ushtarë, municion dhe ushqime për forcat turke. Siç thuhet në “Hylli i Dritës”, 1937, “Ndër këto luftime u dan në shëj për trimni bajraktari i Nikajve Sokol Basha, Shytan Brahimi-krye i Nikajt, Gjelosh Rama i Currajt Epërm, Dedë Trimi-krye i Merturit, Tunxh Miftari–bajraktar, Sadik Gjergji shpi e parë në Palç e sidomos trimi i Salcës Prel Tuli, i cili ku me fjalë, ku me urti e burrni diti me trimnue Nikaj e Mertur, tuj pri

nga Qafa e Kolçit deri në Qafën e Agrit, gjenerali Turgut Pasha e kish kuptuar më në fund se malësia e Nikaj–Merturit dhe ajo e Dukagjinit ishin të pakalueshme për ushtrinë e tij. Ai nuk e mori dot guximin të sulmonte Qafën e Agrit ndaj urdhëroi Ali Begun të kthehej mbrapsht. Në tërheqje e sipër, duke shfryrë gjithë mllefin për humbjen e turpëshme që pësoi, ushtria turke dogji dhe shkatërroj plagosen pa mëshirë çfarë zuri përpara. Të tërbuara, si kafshet e egra kur për vdekje, turqët me 22 dhe 23 korrik 1910, ju turrën Salcës dhe Palçit duke i djegur e rrenuar mbi 60 shtëpi. Shkatërruan ekonominë, duke prerë dhe arat me misër të njomë, rrushët dhe pemët. Këtë terror të shfrenuar ata e ushtruan kudo ku kaluan gjatë kthimit për në Gjakovë. Por, gjatë kësaj rruge ata u gjetën edhe nën goditjet e herë pas herëshme të luftëtarve malësorë, të cilët u shkaktuan humbje të tjera si në njerëz edhe në materiale. Këtë dështim të turpshëm të ushtrisë turke populli e ka përjetësuar në vargjet e këngës së tij: “Mos pushoni, bini burra! / Anadolli s’po qëndron, / U vu n’tikun nga kufini / Asht ma hana ka kalon, / ...Qafës Kolçit rrugës shpumë, / Ku ndjek rruga për në Pejë, / Me ushtri të përgjysmume, / I turpnuem si grue e vejë /...”.

Me qëndresën heroike të vitit 1910 kundër ushtrisë turke, krahina e Nikaj–Merturit dhe e Dukagjinit shkruan një nga faqet më të lavdishme të historisë së tyre. Kjo u arrit, sepse këtu në këto male kishte një popull që i printe flamuri kombëtar dhe ideali i lirisë për ruajtjen e vatanit. Qëndresa e Nika–Merturit dhe e Dukagjinit kundër ekspeditës ndëshkimore të Shefqet Turgut Pashës, dhe thyerja e saj këtu në këto male ku ndër shekuj jetonte, punonte e luftonte një popull me mendje të ngulur në liri, ishte flakë e fuqishme në zjarrin e kryengritjes shqiptare të vitit 1910, e cila shënoi fillimin e një etape të re e më të lartë në luftën e popullit tonë për pavarësi kombëtare. Jehona e kësaj qëndrese u përhap kudo në Malesi, Kosovë e mbar Shqipërinë. Ajo fitoj admirim kudo dhe rriti besimin e popullit për fitore të reja. Kjo qëndresë hyri dhe mbeti në historinë e popullit shqiptar si një nga ngjarjet e shënuara të saj.

Në 110 - vjetorin e kësaj qëndrese, ne, pasardhësit e atyre burrave dhe grave që luftuan e sakrificuan gjithçka për lirinë dhe pavarësinë e Atdheut, përulemi plot respekt e mirënjohje përpara sakrificave të tyre, por dhe kemi të drejtën legjitime të krenohemi me baballarët, nënat dhe gjyshstërgjyshërit tanë që na lan trashegim këto faqe të lavdishme të historisë së kombit.



Duke u mbështetur në përvojën e lufrave të mëparshme, Mehmet Shpendi–udhëheqës i Djelmnisë së Shalës, po dhe udhëheqësi kryesor i kësaj qëndrese antiosmane, do t’i ndante forcat e luftës sipas zonave

cekën me u ba copë e grimë e me qindrue për Atdhe...”.

Kështu forcat turke të gjeneralit të famshëm Turgut Pasha u gjetën në ditët më të vështira që nga krijimi e deri atëherë. Fronti i T’thermes nuk po

ai vetë ma i pari në çdo luftim...”.

I gjendur ne një situat tepër të vështirë pas 14 ditë luftimesh, midis malesh dhe honesh të pa shkelura ndonjëherë nga ushtritë e huaja, ku kriste pushka kundër forcave turke

Pulti n`Feste, Festa e Qereshit

Ngjarjet e ndodhura ato ditë të korrikut 1915 janë të ruajtur dhe rrënjësura thellë në mëndjen e popullit të Plan-Gjurajve dhe Dukagjinit. Ndonëse kujtime të trashëguara nga të parët, këta banorë nuk mundë të harrojnë luftimet e ashpëra, dhunën barbare të okupatorit malazez mbi banorët e fshatrave Plan-Gjuraj. Nga gjithë Dukagjini janë plot 106 të rënë, prej tyre 81 të rënë në mënyrë heroike në Plan dhe vetem nga fshatrat Plan-Gjuraj 75 luftëtarë, që dhanë jeten në mbrojtje të atëdheut, në mbrotje të lirisë. Sot, 81 dëshmorët kujtohen dhe emrat e tyre janë të skalitur në lapidarë dhe në kryqin e ngritur dhe restauruar, në vëndin e gjakëderdhjes më të madhe të kesaj luftë, në "Qeresh". Kjo ngjarje historike përkujtohet çdo vit që nga që nga data 15 korrik 1940.

Për të tretin vit radhazi Bashkia Shkodër vazhdon traditën e veprimtarin "Pulti n`festë" ku krahas përkujtimit të luftës së Planit bëhet promovim i vlerave dhe resurseve natyrore, kulturore dhe gastronomike të zonës së Pultit. Në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Shkodër pikërisht në 105 vjetorin e Luftës së Planit më datën 15. 07. 2020, të pranishem ishin banorë të fshatrave të Njësisë Administrative Pult, familjarë të dëshmorëve, përfaqësues të Bashkisë Shkodër dhe përfaqësues të Shoqatës "Dukagjini" (N/kryetari Agron Hasanaj dhe anëtarja e kryesisë-Klodjana Serraj), të cilët vendosën kurora me lule dhe bënë homazhe në nderim të dëshmorëve që dhanë jetën për atëdhe e që sot pas 105 viteve na bëjnë të ndjehemi krenar.

Veprimtaria u përshendet nga z. Arben Gjuraj, nënkryetari i Bashkisë Shkodër, i cili shprehi vleresimet e tij për mikpritjen, traditat dhe mrekullitë natyrore të zonës së Pultit.

Z. Tom Marku, administrator i njësisë Pult, përshendeti të pranishmit duke theksuar rëndësinë e promovimit të Pultit, produkteve, natyrës e të gjithë historisë së lavdishme të kesaj zone. Z. Marku bëri një prezantim të Vëndimit të Këshillit Bashkiak Nr. 46 datë 24. 06. 2019 "Për emerimin e Rrugëve në Njësinë Administrative Pult", nga i cili rrugët e Njësisë

Pult janë emruar me emra të figurave të shquara të zonës së Pultit. Gjithashtu ai u shpreh optimist mbi punën e Ekipit Kombëtar të Arkeologjisë, i cili së shpejti do të bëjë matjet dhe pikat e rilevimit, me qellim shpalljen e Kështjellës së Spanëve "Park Arkeologjik Kombëtarë".

Në emer të i shoqatës "Dukagjini", Z. Prelë Shytani shprehi rëndësinë e përkujtimit të kesaj ngjarje historike për mbarë Dukagjinin.

Pas këtyre momenteve, të pranishmit paten rastin të shijonin gatime tradicionale të zonës së Pultit si dhe momente muzikore të organizuara nga Grupi Folklorik "Treva".

Pjesë e programit ishte edhe vizita e vendburimit të lumit Kir, tashmë një atraksion i njohur nga të pranishmit në festat e mëparshme "Pulti n`festë". Z. Angjelin Vata, banorë i lagjes Bokes, fshati Gjuraj, i apasionuar pas natyrës dhe fotografisë, kishte kënaqësinë të shoqeronte grupin e pranishem nga Bashkia Shkodër dhe disa të rinjë pjesë e grupit "Ambjentalistat e Rinjë".

Ju paraqesim disa komente të dala nga të pranishmit në veprimtarinë "Pulti n`feste".

Takimi dhe kuvendimi me banorët e Pultit, është një kënaqësi e veçantë. Ato janë të drejtpërdrejtë, flasin hapur dhe me një mençuri që duket se buron natyrshëm, ashtu si uji i ftohtë i lumit të Kirit që përshkon të gjithë zonën.

Infrastruktura rrugore e bën shumë të vështirë zvillimin turistik të zonës.

Një natyrë mahnitëse, njerëz të mrekulueshëm dhe mikpritës, bartës e përcjellës të traditave qindra vjeçare.

Duhet bërë më shumë promovim i krahinës, aveprimtari të tilla janë shumë të rëndësishme.

Lavdi Dëshmorëve të Planit dhe Dukagjinit!

Unë, në rolin e prezantuesit të kesaj veprimtarie e ndjej veten shumë krenar dhe i lumtur që kisha mundësinë të jem pjesë e "Pulti n`festë", pikërisht në vëndlindjen time Boks-Gjuraj. "Festen e Qereshit" e ndjek që i vogël, është një traditë që duhet ta vijojë, të gjithë së bashku duhet të bëjmë më shumë, për veten tonë,

për familjet tona, për Gjuraj - Planin, për Pultin dhe Dukagjinin.

Vilson Peshkaj



Agron Hasanaj, N/kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe anëtarja e kryesisë, Klodjana Serraj, duke vendosur kurorë pranë lapidarit të dëshmorëve të Planit.



Prezentuesi i kesaj veprimtarie Vilson Peshkaj dhe pamje nga pjesëmarrësit në ketë përkujtimore



Arben Gjuraj, N/Kryetari i Bashkisë Shkodër



Tom Marku, Administratori i Njësisë Pult



Prel Shytani, anëtari themelues i SHA "Dukagjini"



Këngëtarët e mirënjohur Ndue Shytani e Fran Kodra, të grupit folklorik "Treva"

Mehmet Shpendi - simboli i qëndresës së Dukagjinit

- Kronikë përkujtimore në 105 vjetorin e rënies -

Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me rastin e 105 vjetorit të rënies së atdhetarit Mehmet Shpendi, pranë monumentit të tij, në sheshin e zonës Industriale, organizoj një ceremoni përkujtimore.

Në këtë ceremoni morën pjesë anëtar të SHAD, banorë të Dukagjinit, të qytetit Shkodër dhe familjare të familjes së Mehmet (Sokol) Shpendi, në baze të mundësive që na krijoi pandemia.

Pranë monumentit u vunë kurora me lule, në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", kryetari i saj, Ndue Sanaj dhe N/kryetari, Gjergj Leqejza. Pastaj vunë kurora familjaret e Mehmet Shpendit.

Hapja e ceremonisë u bë nga Kryetari i Shoqatës, Ndue Sanaj, që në mes të tjerave theksoi: "Muaji korrik është muaji me ngjarje madhore, që e bën Dukagjinin një emër të rëndësishëm në historinë e Shqipërisë.

*Me 10-24 korrik 1910, banorët apo luftëtarët e Nikaj e Merturit u ndeshën me ushtrinë turke nën komandën e njërit nga pashallarët më të fuqishëm të kohës së Perandorisë Osmane dhe në Qafën e Agrit u thye nga forcat e Dukagjinit të drejtuara nga Mehmet (Sokol) Shpendi dhe u detyrua të kthehet në drejtim të Pukës për të hy në Shkodër.

*Korriku i vitit 1915, ishte muaji, në të cilin banorët e Dukagjinit, në veçanti banorët e fshatit të Planit, shpaleshën shpirtin lirisht duke u sakrifikuar me 106 të rënë në këtë rezistencë, në mes të cilëve, 81 të rënë në Plan.

*Në këtë muaj, me datën 15 korrik 1915, vritet edhe atdhetari, Gjenerali popullor, Mehmet Shpendi, bashkë me Çun Nikën e Marash Delinë, që të tre duarlidhur e pabesisht,

Dje në këtë kuadër, nga bashkia Shkodër, administrata e Njesisë Administrative Pult, në Qeresh, është organizuar një veprimtari, kushtuar kësaj ngjarje.

Këto ngjarje luftarake për liri e parësi na bëjnë më shumë krenar".

Fjalën e rastit e mbajti zoti Luigj Shyti...

Përsëritet historiani Dom Nik Ukgjini ...

Përsëritet N/kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", studiuesi e publicisti, Prele Milani

Përsëritet në emër të familjes së Mehmet Shpendit, zoti Aleks Martini

...

Kjo ceremoni u mbyll, me thirrjen:

Lavdi banoreve të Dukagjinit!

Lavdi të rënëve për liri!

Lavdi jetës e veprës së Mehmet Shpendi!

REDAKSIA



“Shqipëria-Trikot”-shpk, një rrugëtim për rritjen cilësisë dhe mirëqenies së vendit

Të sigurosh të mira riprodhuese nëpërmjet faktorëve material të investimit është një nga burimet më të rëndësishme të zhvillimit afatgjatë të ekonomisë të një vendi. Po çfarë do të thotë të investosh në një vend në tranzicion të gjatë si vendi ynë? Mund të themi që është sfiduese dhe kërkon më shumë përpjekje por jo e pamundur. Shembulli më i mirë pozitiv i këtij sukcesi është sipërmarrja “Shqipëria-Trikot”- shpk.

Kompania operon prej 24 viteve në tregun tonë dhe është një nga kompanitë më të mëdha në sektorin e prodhimit të tekstilëve për eksport. “Shqipëria-Trikot” vjen si një filial i kompanisë “Cotonella” në Itali, me administrator z. Gjergj Leqejza një emër shumë i njohur për gazetën “Dukagjini”, për Shoqatën Atdhetare “Dukagjini” dhe për çdo veprimtari socialo-kulturor të zhvilluar në qytet dhe me gjere. Sigurisht që kompania e Cotonelles nuk do të ishte rastësisht në Shqipëri pa pasur një historik zhvillimi të saj, i cili daton këtu e pothuajse 50 vite më parë, ku në 1972 ne Edolo të Valle Camonica të Italisë, themeluesi i saj Maurizio Zannier do të hapte një laborator të vogël prodhimi tekstil, i cili në 1989 do të shndërrohej në kompaninë lider, që është Cotonella. Siç e dimë bashkëpunimet Italo-Shqip-

tarë kanë rezultuar gjithmonë të suksesshme dhe i tillë është dhe Cotonella-Shqipëria-Trikot, që vjen si një biznes i madh. Nëse flasim për hapësirat e saj fizike ka një sipërfaqe prodhuese rreth 25 000 m², me rreth 650 punëtorë, ajo arrin të eksportojë në vit rreth 13 milion palë tekstile.

Lënda e pare vjen direkt nga laboratorët që operojnë në Itali, pasi arrin në Shkodër bëhet një ri-kontroll i dytë në laboratorët e “Shqipëria-Trikot”, e cila menaxhon operacionet e prerjes së pëlhurës, të prodhimit dhe të logjistikës, përfshirë edhe kontrollin e cilësisë së lëndës së pare dhe të produktit të gatshëm konformë standardeve të larta italiane dhe të direktivave të ISO 9001 2008, për marka prestigjioze si Cotonella, CoopItalia, Kaufhoff, Esselunga Triumph dhe shumë klientë të tjerë.

Ka një teknologji moderne dhe bashkëkohore, për të vizituar ndërmarrjen “Shqipëria-Trikot” duhen orë të tëra, pasi hapësirat ku janë sistemuar repartet e punës, proceset e përpunimit teknologjik e kompjuterik, depot e magazinat, pa lënë



Shqipëria Trikot shpk, Cotonella

mënjë dhe zyrat e administratës, janë të pafundme. Në të vërtetë është vetëm një pjesë e veprimtarive të ndërmarrjes,

pasi ato shtrihen edhe në tetë degë të tjera prodhimi, një objekt i ri i standardit evropian, sepse përveç certifikimit, çdo vit minimumi i nënshtrohemi kontrollit për standardet e cilësisë nga institucionet e specializuara në Itali dhe sidomos nga klientët tanë kryesorë, që janë shumë rigoroz dhe kërkues në respektimin e procedurave të cilësisë.

Nga përshkrimi i kompanisë shikojmë se të ndërtohet një kompani të tillë dhe mbi të gjitha të tëra bashkë, kërkon punë, përpjekje, staf të përkushtuar dhe mbi të gjitha një vizion të madh. Kompania e Cotonelles në Itali si dhe e Shqipëria në Trikot, në Shqipëri i zotërojnë mjaft mirë këto cilësi, ku është vizioni i përbashkët i tyre, është “Qualita & Benessere” (“Cilësi dhe Mirëqenie”).

Mesazhi që mund të përcjellim, le të punojmë pak më shumë, të përkushtohemi pak më shumë, të jemi më të përlulur për punën e denjë dhe është gjysma e punës e bërë.

Klodjana Serraj

GRUPI FOLKLORIK “PETRALBA”, TRASHËGUES I DENJË I FOLKLORIT MATJAN

Tre vite më parë, më 10 korrik 2017, disa artistë të njohur u mbledhën për të themeluar një grup folklorik me qendër në Klos. Grupi mori emrin simbolik “Petralba”, emër i kështjellës së lashtë me histori të ndritur që nga kohët ilire e gjer në ditët tona. Kryetar u zgjodh instrumentisti i talentuar, Ikli Punavija. Mbi realizimin e veprimtarive folklorike të këtij grupi në Klos, qytete të Shqipërisë, në Republikën e Kosovës, në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në Republikën e Malit të Zi, informoi z. Ramazan Mjeshtri, drejtor i Zyrës së Arsimit, Kulturës, Sporteve e Turizmit.

Edhe pse në kushte pandemie, z. Ikli Punavija, kryetar i Grupit Folklorik “Petralba”, bëri të njohur platformën artistike për realizimin ideor dhe artistik të Festivalit virtual Folklorik Kombëtar “FestFolk Klosi” 2020. Një organizim i tillë vjen si pasojë e bllokimit të të gjitha festivaleve kombëtare të folk-



lorit, përfshirë dhe atë Kombëtar të Gjirokastrës, për shkak të masave mbrojtëse nga pandemia covid-19.

shqipe në Shkollën 9-vjeçare Fullqet dhe në Gjimizin “Shaban Çollaku”, Klos; aktualisht kryetar i Institucionit Kulturor

Në vazhdim, z. Blerim Gashi, njoftoi mbi themelimin e Ansambllit Folklorik Burimor Kombëtar me qendër në Prizren. Bordi drejtues, i përbërë nga Blerim Gashi, Burhan Limani, Gjoni Kosteri, Ikli Punavija, Jakup Krasniqi, Ndoc Fusha, Sulejman Beqaj, dhe Hajri Ismani, kryetar të Ansambllit zgjodhi z. Ikli Punavija.

Në vazhdim të kësaj feste folklorike klosjane, me rastin e 3-vjetorit të krijimit të Grupit Folklorik “Petralba”, u promovua botimi i ri monografik “Mozaik vitesh me aromë folklori”, i autorit matjan, Hamdi Huska. Për vlerave publicistike të këtij libri, foli shkrimtari Gjokë Dabaj, ish-mësues i gjuhës dhe i letërsisë

“Përkujdesja Gjithshqiptare”.

Na nderuan me pjesëmarrjen e tyre, Bashkia klos, zv/kryetarja e kësaj bashkie Adelina Laci, Qendra Kombëtare Veprimtarive Folklorike Tiranë, zj: Jonida Cunga- specialiste folklori - Doktoreshkencash ne etnologji-folklor, Prof. Mr. Blerim Gashi - Prizren, Dashnor Gërmizaj kryetar i Unitetit Global-Prizren, Flurim Shala - Selektor i Kombëtares Republikës Kosovës, rapsodët nga Lezha - Llesh Gjini Prenga dhe Lorenc Prenga, Igli Tomçini - djali i kompozitorit Përparim Tomçini, Sokol Meta- drejtor i Qendrës Kulturore Mat, Drejtorja Arsimore Bashkia Klos zj: Teuta Karaj, Zyra Arsimit, Kulturës, Turizmit e Sporteve Bashkia Klos zoti Ramazan Mjeshtri, anëtarë këshillit bashkiak klos zj: Drita Bala, studjuesi Gjokë Dabaj, muzikanti Sela Eral dhe anëtarë të këtij grupi folklorik.

Në fund u dhanë mirënjohje për kompozitorin Përparim Tomçini (pas vdekjes), folkloristin e njohur matjan, Sabri Aliaj dhe instrumentistin popullor kosovar Adem Gashi.

Prof. MR BLERIM GASHI, kryetar i kuvendit Ansambllit Folklorik Burimor Mbarkombëtar

THETHI, QERSHIA MBI TORTË E ALPEVE

I përqaftuar nga bjeshkët e Nemuna, në skajin më verior të vendit, fshati i Thethit u bë i njohur në mbarë trevat e Shqipërisë dhe jashtë kufijve të saj. Me natyrën e bukur të Alpeve që e rrethojnë, me vlerat e shumta që brezat i pasuruan i ruajtën dhe i trashëguan në shekuj. Kur përmendim Alpet e Shqipërisë s' pari kemi kuptuar Thethin, kur përmendet Thethi kemi kuptuar Alpet e Shqipërisë.

Kështu pra, këtë lidhje të forte mes bukurive dhe vlerave të pa zëvendësueshme nuk mundë ti gjesh askund më kuptim plotë e më të pa ndarë, se Thethi e Alpet. Çdo vizitor vendas ose i huaj në Alpe mahnitet, dashurohet në mes bukurive e vlerave, me pasuritë e një natyre të radhë. Krojet nënë mriçe, burimet në sqetullat shkëmbore. Me rrjedhjet e shumta të ujerave, të cilat formojnë shtretërit e prerjeve. Duke kaluar mes pyjeve me lloje të ndryshme bimësie. Lulet e shumta, ajri i pastër i larë me borë, njerëzit të dashur, të thjeshtë, të pastër si natyra e këtij vendi që i rriti. E vlera të tjera që ne nuk po i përmendim. Ishin dhe janë pasuria e Thethit, çatia e Alpeve të Jezercesës në bjeshkët e Nemuna!

Vendosja e të parëve në Theth është e hershme. Kjo vërtetohet nga disa studime arkeologjike, nga arkeolog vendas e të huaj të bëra në Grunas në vitin 2006. Sipas të dhënave rezultojnë se ky fshat ka gene i banuar 850 vjet para Krishtit. Por i dokumentuar Thethi shfaqet në defterin e Sanxhakut të Shkodrës në vitin 1485 me emrin Fushë, me 7 shtëpi. Pra, këto bukuri të radha kanë ngjallë interes prej shekujsh nga njerëzit. Kur ndahet diçka, thonë se i fundit o qeshë o qanë. Por kur Zoti i ndau të mirat e kësaj bote, mbase Thethi ishte i fundit dhe vërtet qeshi!!

Monumentet e natyrës, të cilat janë ndërtuar në shekuj në Theth. Këto sikur zoti i ka skalitur me dorën e tij, madje duke pasur shumë kohë në dispozicion. Lumi që buron nga shkalla e Pejës dhe ndan përgjysmë Thethin dhe gjithë krahinën e Shalës. Ujëvara e Grunasit i shpallur monument natyre. Kanioni i Gerlesë, Syri i kaltër, shpella e Harapit, Bira e rrathëve rreth 4 km nga lagia Ulajat, e cila rrinë me derë hapur, pretë e përcjellë vizitor, brenda së cilës janë të fshehura bukuri të radha. Një galeri nëntokësore e bukur, por edhe e virgjër nga studiuesit vendas apo të huaj. Por jo nga disa duar të pa përgjegjshme, të cilat e kanë dëmtuar, duke thyer stalagmitet e statiket që ndodhen brenda saj!

Monumente të natyrës mundë të quajmë çdo maje, qafë apo shteg që e rrethon Thethin. Rrugët e shkelura në mes bjeshkëve të bukura, peizazhet e radha të natyrës, ku kanë jetua e jetojnë Thethjanët, si në grope të Rragamit, buni të Valbonës, në sukë të Grunasit, në shkëmb të Ded kolës etj.

Thethi është i pasur edhe me monumente të historisë. Thethi ka luftuar për të mbrojtur këtë perlë. Madje jo të dokumentuara, por të nisur nga ato se çfarë kanë treguar të parët janë zhvilluar beteja të përgjakshme, si në qafë të Pejës në Dhom të Aliçet në Rragam etj. Për të mbrojtur këtë pasuri të radhë, po edhe të lakmuar nga të tjerët. Monumentet e historisë janë të shumta, po le të ndalemi në disa prej tyre.

Kisha e Thethit e ndërtuar në fillim të shekullit XIX nga Thethjanet. Kjo pësoi persekutimin më të rëndë gjatë historisë



të një objekti kult. Tre herë u dogj, fillimisht e dogjën forcat rebele të Ahmet Zogut të kryesuar nga Muharrem Bajraktari dhe Gjenerali Preng Previzi. Kishën e kthyen në burg. Ku torturuan u vranë dhe u vunë litar shuma burra të Thethit, por edhe të gjithë Dukagjinit, plaçkitën e dogjën shtëpiat si hakmarrje për lëvizjen antizogiste të Dukagjinit, në vitin 1926. Kjo u mbyll dhe u shkatërrua edhe në kohën e diktaturës. Por, s' fundit kjo u rindërtua nga Thethjanët që jetojnë në Amerikë, siç janë Ndue Mark Vuksanaj, Nik Gjergji, Nik Kola e Tom Gjoka. Kjo Kishë ruan në gjirin e saj histori të dhimbshme, por edhe krenare. Në këtë Kishë kanë shërbyer priftërinjtë me emër si At Shtjefen Gjeçovi, Pater Anton Arapi, at Zef Pllumbi, etj. At Shtjefen Gjeçovi hapi shkollën e pare shqipe në vitin 1917. Po mesa del se origjina e para dhjetë breznive At Shtjefen Gjeçovi e ka në Thethi, nga lagia Gjeçaj. Thethi ka nxjerrë klerik të njohur si Pater Daniel Gjeçaj, Pater Ambroz Martinaj etj. Është domethënëse ndërtimi i shkollës re. Nga kryqi i kuq Amerikan në vitin 1921. Pra vetëm 4 vite pas hapjes së shkollës pare Shqipe, në Theth. Sot, ajo ka vetëm rrënojat, shkatërrimi i saj duket se u bë në luftë kundër Imperializmit Amerikan!

Rast i pare në Shqipërinë e asaj kohe të gjesh investime Amerikane. është në nderin e Dikasterit dhe të Bashkisë Shkodër ta ndërtojnë në kuadrin 100 vjetorit atë shkollë siç ka qene. Dhe të vendoset një pllakat, ku të shkruhet: "Shkollë e ndërtuar nga Kryqi i kuq Amerikanë, në vitin 1921".

Objekte historike në Theth janë të shumta. Shtëpia e Lulash Keqit e shpallur monument kulture shumë vite më pare dhe që mbrohet nga shteti. Kjo shtëpi për vetë natyrën e të ndërtuarit ka një vlerë të rëndësishme muzeale. Ndërtim, i cili

klimën, ajrin e pastër, ujin e kristaltë, bujarin dhe mikpritjen e këtyre njerëzve të papare. Për të gjitha këto që i theksuam më lartë. Duke marrë vlerësime brenda e jashtë Shqipërisë, ky fshat është lakmuar shumë. Kjo bëri që në vitin 1936 të hapet rruga automobilistike, e cila lidhë Thethin me Shkodrën. Kjo bëri, që Thethi, në atë kohe të jetë kryeqendra e Dukagjinit. Në vitin 1947 këtu grumbulloheshin të gjitha produktet bujqësore e blegtorale. Por bëhesh edhe ndarja e racionit të varfërisë. Prandaj ky fshat priti e përcolli me qindra dukagjinat, duke ndarë bukën e gojë me këta shtegtarë. Kjo ishte dëshmia më e mirë, për bujarin e Thethjanëve. Në fillimet tranzicionit ashtu si në të gjitha fshatrat, një pjesë e madhe u larguan për në mërgim apo në qendrat urbane për një jetë më të mirë.

Por, ka mbi 10 vjet që shumë prej tyre janë kthyer e po investojnë në turizëm. Janë me dhjetëra e dhjetëra bujtina të ngritura, të cilat presin me mijëra e mijëra vizitor vendas e të huaj. Këto bujtina janë ndërtuar apo restauruar, duke bashkuar traditën me modernen. Duke i dhënë më shumë prioritet traditës si në ndërtime, arodime e kulinare. Është kënaqësi kur e sheh se si Thethi po ndryshojnë për mirë. Po, rikonstruksioni i rrugës nga Qafë Thorja në

Theth po zgjerohet deri 5 m. Sipas projektit do bëhen disa tunele, për ta mbrojtë rrugën nga ortekët. Asfaltimi i rrugës shkurton shumë udhëtimin e turistëve e vizitorëve, po dhe të banorëve, të cilët kanë investuar e investojnë çdo ditë. Dukagjinat thonë, Zoti ua shtoftë inatin, që rikonstruktimi kësaj rruge me të njëjtat parametra të lidhin Thethin me Prekalin. E me siguri do shpallen para syve të gjithë secilit pamje madhështorë. Një pengesë për investime të mëtejshme është mungesa e mos dhënies të çartefikatave të pronësisë sipas kufijve të vjetër! Kjo duhet të marrë zgjidhje sa më pare nga qeveria. Kjo do ishte në nderin e Qeverisë Rama të plotësojë zonat malore me tapi. Për tu kthyer përsëri të titulli i shkrimit, se Thethi mbetet mahnitës edhe në dimër. Kur gjithçka vesh petkun e bardh e majat e maleve duken madhështorë me veladonin e nusërisë.

Pra, Thethi pamje madhështorë ka në verë e dimër.

Ndoshta në Theth, Fishta mori frymëzimin e tij për Lahutën e Malcisë. Gjithçka në zhvillimin e Thethit do marrë për mirë, duke ruajtur traditat e të parëve. Këto e shumë e shumë bukuri e bëjnë Thethin qershia mbi torte e Alpeve.

Përgatiti **NDUE ZIÇI**

Po Thethi, është bërë i njohur për

LETRA E MARTIN CAMAJT

- Nxjerr nga arkivi im dhe mban datën 25 korrik 1991 -



Na transferuan në Radion e re. Mba-ja po të njëjtin pozicion, si në radion e vjetër, atë të redaktorit të emisioneve artistike.

Ishte fillim korriku. Viti 1991. Pাপritur më kërkon të më takojë një njeri që thjesht e njihja si Nika i Kinemasë. Një burrë me trup djaloshi dhe shumë fisnik. Nika më thotë: “Xhahid, unë kam një dajë. Dhe ai banon në Gjermani. Shkruan vjersha. Sikur të bëje një emision, sa do të gëzohej.” “E pyes: - Nik, si quhet daja?” Nika më përgjigjet: “Martin Camaj”. I them: “Që të jem i singertë me ty: - Nuk e njoh dhe as nuk ia kam dëgjuar zërin dhe emrin, ndonëse po më bëhen një jetë që merrem me libra, lexime dhe studime. Të lutem, më sill ndonjë libër, që të njihem më mirë.”

Nika nuk vonoi dhe më sollti tre libra, që të tre të panjohur për mua. I lexova. I rilexova. M’u duk vetja i vogël para madhësisë së talentit të tij. I vogël... Pyeta veten: “Përse kjo panjohje? Përse kjo heshtje? Çdo poezi ishte një amanet për Shqipërinë dhe tokën që e lindi dhe e dashuroi deri në frymën e fundit. Poezitë – ishin një mrekulli...” Kaq mendova atëherë dhe kaq shënova në fletën e arkivit tim, që e ruaj si sytë e ballit.

Të nesërmen, e fillova punën duke takuar aktorët më të mirë të Teatrit “Migjeni”. E pranuan propozimin tim për të bërë një montazh muziko-letrar me poezitë e Martin Camajt. Kisha punuar pothuajse gjithë natën dhe ia kisha dalë mbanë.



Dua të them, në atë montazh muziko-letrar pashë një dashuri dhe zemër të madhe të interpretimit të aktorëve, pashë një dritë që nuk e kisha parë ndonjëherë, siç duket, dhe kjo ishte e vërteta, vinte nga drita hyjnore e poezive të Camajt. E kujtoj dhe tani forcën emocionale dhe dimensionin aktorsk të Bruno Shllakut.

E përfunduar emisionin. E dhamë. Bëra dhe një kasetë për Nikën, ku i shkrova dhe ca fjalë Martinit. Fjalët janë këto: “Më zgjate jetën me kuro-rat vezulluese të poezive të tua. Thitha shumë ajër Shqipërie. Unë të pres në Shkodër. Je miku im! Të përsëndes dhe të them: - Shumë faleminderit!”

Pas ca ditësh, u thirra në zyrë nga drejtori im. Ashtu idhnak siç ishte, më kërcënoi me gisht, duke më thënë: “Duhet të më pyesje mua!” E kuptova se ai ende jetonte me frikë, ndonëse

hiqej si demokrat. Nga natyra kam qenë kokëfortë dhe nuk largohem nga e imja. Këtë parim e kam edhe sot. Iu përgjigja: “E kam bërë me koshiencë. Mbaj përgjegjësi vetëm unë. Martin Camaj duhet nderuar. Është turp për ne që e kemi lënë në harresë.”

Pas ca ditësh, erdhi, përsëri, Nika. I shkëlqenin sytë. Nuk dinte si të më falënderonte. Ai më dha një letër që ma dërgonte Martin Camaj. Mbante datën 25 korrik 1991. Po e jap në fb. (disa fragmente) për herë të parë.

I dashur Z. Bushati

Kam marrë letrën e shiritin dhe të falënderoj Z. Bushati (Xhahid) e të gjithë ata që kanë marrë pjesë në përgatitjen e emisionit (në Radio Shkodra), Ka fort për zemërsi brenda, që e shkëmbej edhe sot si edhe më parë. Shumicën e jetës në Shqipëri e kam kaluar në Shkodër. Përmbi Shkodrën



kam një dramë të pabotueme, në të cilën herë mbas here punoj tash 25 vjet.

Vjet qesh në Kosovë sepse ishin keq. Po ngjan kështu se, sidomos sot “familja ime” u ba tepër e madhe dhe ndjej përgjegjësi jo vetëm për familjen e ngushtë që jeni ju. Deri sa të më mbajnë fuqitë, nuk do të kursehem, sidomos të mbetem zëdhënës për hallet e popullit tonë kudo gjindet.

I jueji

Martin Camaj

Në arkivin tim, gjeta, gjithashtu, edhe këtë telegram:

Shkodër Shkodër 2111 20 29/3 10
(kopju 29/3 10 30 firma)

z. Xhahid Bushati
Radio Shkodra

Vllaznit e Martin Camajt presin ngushllime datë 1/4/92 në familjen Camaj Temal

Familja Camaj
kl 1/4/92

Shënimi im: Në pamundësi për të shkruar, në shenjë respekti mendova t’iu bëj një telegram ngushëllimi. Mjerisht për disa ditë me radhë nuk punuan linjat. Megjithatë jo për fajin tim, por mua më mbeti peng në zemër...

Xhahid Bushati,
Shkodër, korrik, 2020

RIKARD LJARJA, JETË ARTISTI

- Jetë, që duhet falënderuar! -

Në kujtim të Artistit, Mjeshtrit Rikard Ljarja,
(01.04.1943 - 20.04.2020)



Xhahid Bushati
shkrimtar

1.

Nuk më besohet ende, se Rikard Ljarja është larguar nga kjo botë. Se ka shkuar në amshim. Ngaqë nuk më besohet, më ngjan sikur e pres... e ai po vjen... me hapin e tij të lehtë si një poezi e ngrohtë me tingull muzikor, me të qeshurën e tij që çel trëndafilat e vjollcat, me sytë që i shndrisin si yjet e një qielli të ëmbël nate, të një qielli shkodran. E pres të pimë një kafë në lokalin e mikut të tij të ngushtë, Sadi Bakut. Sadiu, edhe sot, kur përmend Rikardin, i dridhet buza, sytë dhe zëri i përletot, kujtimet herë pas here i kthehen në mall e lot.

E pres Rikardin si një mall i pashteruar për Shkodrën e tij të dashtun.

2.

Rikard Ljarja u takon atyre artistëve, që janë si gurët e rrallë, që shndrisin e rrezatojnë: në skenën e teatrit, në celuloidin e filmit, në jetë e përditshme, në jetën e gjithmonëshme.

E njoha si një qytetar i mirë shkodran, si një intelektual i kulturuar, shpirtmadh e humanist. Rikardi ishte dhe historian. I njihje mirë ngjarjet dhe historitë e Shkodrës. Rikardi ishte dhe enciklopedist. Të fliste me detaje për shumë pemë gjenealogjike të familjeve shkodrane. Tregon-te... dhe i rrëfente bukur, plot ngjyra, frazeologji e dashni. Dhe mua më dukej se çdo derë shkodrane hapej për Rikardin, si për një mik kaheerë të njohur, të dashtun e buzagaz.

Dimensioni i lirisë ishte i gjithëpush-tetshëm te Rikardi: në mendësi, arsytim, dialog, argument. Po e tillë ishte dhe kultura. Si e para ashtu edhe e dyta, kishin një autor, që quhej Karlo Ljarja, i ati i Rikardit. Zotni Karlon e ditur e pata njohur, kur punonte në Bibliotekën e Shkodrës. Në atë Bibliotekë, në rrjedhën e viteve, kishin punuar njerëz të ditur, si: Esat Myftia, Izet Bebeziqi, Karlo Ljarja, Sandër Gera, Tef Krroqi, Teufik Gjyli, me kontribute: në letërsi e filologji, studime, përkthime, në zotërimin e gjuhëve të huaja, në fushën e aktrimit, etj.

Zotni Karloja ishte njëri prej atyre të diturve. E kujtoj, si tani: me sytë e tij shprehës si qiell i pastër, me atë bardhësinë e flokëve si nur, që ngjante si mit dalë nga legjendat, ishte model i një kul-

ture gjermane. E kishte udhërrëfyese at kulturë. E gjitha kjo pasuri e çmueshme, përveç të tjerave ia trashëgoi genetikisht të birin, Rikardit, i cili gjatë gjithë jetës së tij e deri në frymën e fundit, e mbajti dhe ruajti si pasaportë fisnike; e zhvilloi dhe iu fal asaj si shenjtëri.

3.

Rikard Ljarja, aktroi në skenën e teatrit "Migjeni" të Shkodrës për afro 8 vjet, duke na dhuruar afro 20 role, pa përmendur ato shfaqje ku ishte regjisor e as / regjisor. Po përmend: - "Si u kalit çeliku", 20.06.1966, roli: Serjozha Pizhek (dublant me aktorin Elez Kadria. Kjo është shfaqja e fundit që vë në skenë regjisori Esat Oktrova, ku është dhe autori dramaturg); - "Cuca që koriti malet", 11.09.1966, roli: Hetuesi; - "I pesti u kap gjallë", 27.11.1966, roli: Marashi (është dhe as / regjisor); - "Fisheku në pajë", 29.07.1967, roli: Frani (dublant me aktorin Rrok Rrotanin); "Ngjarje në fabrikë", 13.08.1968, roli: Jashari (është dhe as / regjisor); - "Drita", 13.10.1968, roli: Petriti (dublant me aktorin Elez Kadria); - "Ditari i një mësuesi", 09.02.1969, roli:



Sadiku (është dhe as / regjisor); - "Lagjja e varfën", 10.07.1969, roli: Sazani; - "Galeria", 11. 09.1 969, roli: Andrea, (dublant me aktorin Nefail Piraniqin; është dhe regjisor); - "Sinjalet e natës", 30.04.1970, roli: Gjergji; - "Toka jonë", 11.11.1970, roli: Leka; - "Mbi gërmadha", 29.04.1971, roli: Shpendi; - "Krisma mbi dekor", 10.07.1971, roli: Besniku (dublant me aktorin Tonin Ujka); - "Viti '61", 25. 11. 1971, roli: Petriti; - "Ëndrra e tokës", 20.12.1972, roli: Mari (dublant me aktorin Fran Vukaj); - "Katër nga armata", 19.03.1973, roli: Gjini (është dhe regjisor); - "Koncert dramatik", 29. 03. 1973; - "Cuca e maleve", 19.05.1973, roli: Hetuesi; - "Shën Gjon Kryepremi", 24. 04. 2009, roli: Gjoni.

Tre interpretime (skedë):

-Ishte në moshë fare të re, kur interpretoi rolin e Hetuesit te drama "Cuca që koriti malet". Më vonë, përsëri në rolin e

Hetuesit, po, te drama "Cuca e maleve" (variant i shkurtuar i titullit të dramës).

Në këtë dramë ishte dhe një skenë, ku ishin përballë njëri-tjetrit: Rikard Ljarja (hetues) dhe Preng Lëkunda (personazh negativ). Në këtë përballje, si interpretim dhe pohimin artistik triumfonte Prenga. Ngaqë duhej rregulluar ky raport, nga këshilli artistik dhe nga disa autoritete të asaj kohe u shfaq mendimi se për të balancuar këtë raport duhet të bëheshin disa prova gjenerale. Dhe ashtu u bë. Aktori Lëkunda e zbuti forcën dhe epërsinë gjatë interpretimit. U krijua ekuilibri i pranueshëm. Por ata që e ngritën këtë problem, nuk thanë asnjë fjalë për figurën e Hetuesit që krijoi aktori Ljarja. Figura e Hetuesit, ishte parë në perceptimin e Rikardit si një tipologji e një hetuesi njerëzor me të vërteta njerëzore, humane e jetësore, të cilat reflektonin brenda shpirtit dhe botës së një Hetuesi, ku përlesheshin: e drejta dhe jo e drejta, e vërteta dhe jo e vërteta.

-Rikardi do të ishte 27 vjeç, kur do të interpretonte rolin e Lekës në dramën "Toka jonë" të K. Jakovës. E gdhendi atë rol! Dha një Lekë me një botë të pasur

ruajti në thelbin e çdo personazhi dramën, parafytyrën dhe imazhin e aktorit skenik, aty, ku filloi së pari jetën e tij prej artisti. Një aktor i besueshëm dhe i vërtetë. Një aktor mahnitës dhe i paharruar.

5.

Rikard Ljarja ishte shkrimtar dhe skenarist. Emrin e tij e mbajnë këto vepra: - "Kur happen dyert e jetës" (skenar për film me metrazh të gjatë), - "Ura dhe kështjella" (skenar), - "Pesha e kohës" (skenar me metrazh të gjatë), - "Në një humbëtitë këtej rrotull" (roman), - "Kohë qensh, etj." (proza të gjata), - "Tymi. Kronikë bardh e zi" (proza të gjata), - "Josifopedia" (roman), - "9 të shkurtra" (prozë), - "Prill" (triptik).

Duke iu referuar krijimtarisë artistike, vërejmë se, nga mënyra se si janë konceptuar dhe ndërtuar ngjarjet, arkitektura dhe kompozicioni, vizatimi i personazheve, narrativa dhe rrëfimi, etj., njëherësh na kujtojnë imazhet e një filmi. Mendojmë se kjo është veçoria kryesore e individualitetit artistik të autorit, sidomos në prozën e shkurtër dhe në atë të gjatë. Kujtojmë romanin "Josifopedia". Një veper e ndërtuar mbi bazën e tipologjisë së personazhit të suksesit dhe venitjes së tij. Josifopedia është produkt i një realiteti dramatik dhe të egër. Nga mënyra se si është strukturuar vepra, si rrëfohen ngjarjet, vizatimi më imtësi i personazheve, ... etj., e bëjnë romanin të një natyre kulturologjike. Ndërsa i një natyre tjetër është libri me proza të shkurtra i titulluar "9 të shkurtra". Me një spikamë kulture, shfaqen dukshëm përdorimi i dendur e plot efikasitetit e fjalive njëkryegjyrmtyrëshe, të cilat ruajnë dendësinë proverbiale të mendimit dhe forcën e emocionit. Ruajnë edhe: ngjyrën, tonin. I japin hapësirë dhe rrjedhë të mëtejshme fabulës së tregimit të shkurtër. Në këtë libër autori Ljarja këtë tipar na paraqet si marrëdhënie komunikimi, i cili mbart dhe ka rol të drejtpërdrejtë. Sepse i tillë ishte dhe Rikardi në jetë, në skenë dhe në film: I drejtpërdrejtë, i kulturuar, i ndershëm dhe pa zhigla.

6.

Rikard Ljarja deri në frymën e fundit ishte një këngëtar dashuronjës i Shkodrës, që e kishte në zemër e për zemër.

Rikard Ljarja ishte një melodi e pakëputur i Vendlindjes së tij. Fjala, zëri dhe fryma e tij ishin refren i qytetit ku lindi. Ndaj e dashuroi dhe e përjetësoi aty shumë Shkodrën sa i la vend meritës edhe në amanetin e fundit: "Dua të prehem në Shkodër, në dheun e qytetit tim! Dua ta puth atë përjetësisht, e përjetësisht të ëndërroj pranë tij."

Të tilla amanete lënë njerëzit e ditur e të famshëm. I tillë ishte dhe Rikard Ljarja, një Jetë Artisti.

Shkodër, korrik 2020

AT GJEÇOVI THERRET: “MOS MA NDRYSHONI GENIN”

“Amanetin nuk e tretë as dheu!”, - populli



Nga: Dr. Gjesh NIKOLLA,

Tiranë, më 25. 10. 2019

Një fjalë e urtë e popullit e trashëguar brez pas brezi dhe shekull pas shekulli thotë: “Amanetin nuk e tretë as dheu”. Të heshtim “NE” për ato që vetë At’ Shtjefën Gjeçovi ka thënë me shpirtin dhe mendjen e vetë, dhe duke lënë të shkruar me dorën e vet është pabesi që i bëhet ashtu siç e vranë në pabesi. Ne nuk duhet ta vrasim për së dyti me heshtjen tonë, por as të ndryshojmë ato që ka lënë vet të shkruar dhe as ato që kanë shkruar të tjerët për të. At Gjeçovi ishte dhe mbetet tempull më vete që ndriçon pa ndërpre brez pas brezi. Ai ishte dhe mbetet një njeri i madh dhe burrë-shtetas i ditur.

Ja si shkruan At Gjeçovi në shkrimin e tij: “Koha e Zgjetave”(Koha e shigjetave). Duke shkruar në Shkodër i pari i Thaçit më emrin e vetë “THAÇ” në Vaun e Dëjes (Deja) takon një djalosh që ishte vetëm dhe nuk dinte së ku po shkante. Kur pa të parin e Thaçit mbi kalë shale e pyeti se për ku ishte nisë të shkante. I pari i Thaçit ju përgjigj në Shkodër më vulos disa gjygyje dhe pleqëni që bëheshin prej të parve të secilës krahinë në Shkodër përpara Krye-zotit. Më merr me veti i tha djali sa me të mbajtë kalin mbasi nuk kam njeri dhe jam i varfër. I pari i Thaçit pasi e pyeti së nga ishte, ky i tregoj së kishte dalë nga fshati i “KOLONJES”. E mori më veti dhe shkuan në Shkodër. I pari i Thaçit pasi pat shkruar disa herë me të Kolonjasin (por tani i lodhur nga pleqëria) e burrat e vllazënisë së Thaçit rreth 50-60 veta, por jo në nivelin e duhur për të përfaqësuar në pleqëri dhe gjygyje. Prandaj i pari i Thaçit shkoj edhe një herë në Shkodër më kolonjarin dhe mbasi i vulosi pleqënit e gjygyjet së bashku më pleqët e tjerë i kerkoj Krye-zotit të Shkodrës që ti jepte leje me dërgue kolonjarin me vulë të flamurit e të vendoste emrin e atij në gjygyje e pleqni që do të bëheshin përpara atij, sepse vetë nuk mund të lëvizte nga mosha lart e poshtë. Kërkesa e të parit të Thaçit u pranua nga Krye-zoti i Shkodrës dhe që nga ky moment filloj kolonjari të bënte lidhjen Thaç-Shkodër për të gjitha gjygyjet dhe pleqnitë të Kryezoti i Shkodrës. Pasi u bë kolonjari si i shtëpisë në vllazëninë e Thaçit kerkoj të fejohej më të bijën e Thaçit. Pasi u këshillua i pari Thaçit më njerëzit e shtëpisë ranë në një mendje (dakord) me ja dhanë kolonjarit vajzën e vetme që kishte në shtëpi. Pasi u martua kolonjari pas 3 vjetësh Thaçi (i pari i Thaçit vdes) kurse kolonjari vazhdonte rrugën si më


përpara pa i kërkuar kush as arsye as vulë. Këtë i linden 3 djem. Sipas At Gjeçovit emni “Kryezi” i mbeti katundit prej emni të të birit të kolonjarit, i cili kishte qene shumë i ithët (kokë fortë). Si zuni vend në Kryezi ky u ba më Kabash, e kështu i mbeti vula në dorë Kryeziut, (mbasi nuk u interesuan thaçjanët), pra i mbeti pleqnia në dorë. Prandaj mbeti fjala “Kryeziu pleqnusja” e Kabashit.

Pra, vula e gjygyjeve dhe pleqnive ishte e Thaçit, por që i mbeti në dorë Kolonjarit (dhëndrit të Thaçit) pas vdekjes së Kryepleqnuesit të Thaçit, sepse nuk u interesuan pasardhësit e Thaçit për vulën e fisit.

Pra, për sa u tha më lart arrihet në përfundimin se: fshati i Kryeziut ka qenë i banuar me Thaç.

Në vitin 1928, me 13 janar At’ Sh. Gjeçovi-Kryeziu tregon: Më bije në mend kur isha fëmijë në shtëpi e kur ndonjeni nga ne ishte i idhët (kokë fortë) e kryeneç plaku Pepa (Petar) Gjeçovi i bërtiste duke i thënë: “Ah Kryezi breh!” Ja biseda e At Gjeçovit në kolegjin e Troshanit, me një prift të shkollës. Si të quajnë e pyeti burri me veladon?. Hilë i tha shkurt djaloshi. Hilë kush? E pyeti po ai zë. Hilë Gjeçi ju përgjigj djaloshi. Nga je? Nga Janjeva e Kosovës. Si ta quajnë babën? Mat, Mat Gjeçi. Ai, më ka thënë së të parët tanë janë nga Kryeziu i rrethit të Pukës. Gjeçi e kanë quajtur të parin e fisit tonë. Në Janjevë prindrit e Gjeçovit, gjyshi apo ndoshta stergjyshi kishin ardhur përpara shumë vitesh. Ata u detyruan të largohen nga malësitë e Pukës, për të siguruar kushte më të mira jetesë. Për një kohë të gjatë ata ruajtën mbiemrin “Kryeziu” për të treguar fshatin e lindjes, por pastaj filluan të mbiemroheshin me emrin e të parit të familjes apo të fisit të tyre “GJEÇI”. Gjeçovi shumë vjet më vonë fjalën “Kryezi” do ta përdorë përsëri si mbiemër të vet, dhe vitet e fundit, kur jetoi e punoi në Kosovë do të shkruaj diçka më tepër. Vet Gjeçovi, në vitet e fundit të jetës së tij na jep disa sqarime për origjinën e emrit të fshatit Kryezi të rrethit të Pukës, për të cilin folëm më sipër. Ndryshimi i emrit kishte të bënte me një traditë të vjetër kishtarë që e shpjegon Rrok Zojzi, në monografinë e vet. “Kur një njeri, pranohet pjesëtar i urdhrit françeskan duhej të ndërronte emrin e të merrte një emër të ri për të treguar kështu se shkëputej nga jeta e më parëshme, nga lidhjet fare fisnore, nga e drejta e trashëgimisë, e pronës e të tjera. Sipas kësaj traditë edhe emri i Mëhill Gjeçit u shëndrrua në Shtjefën Kostandin Gjeçov. Ruzhdi Mata-Gjeçovi Nderi i Kombit Tiranë, Reklama 2000, faqe 5-10. Na duket me rëndësi që etnografi ynë, pas llagapit (mbiemrit) Gjeçov, shënon “Kryeziu”. Ndre Mjeda më 1935 shkruante se arqipeshkvi i Shkupit Carev dhe fretërit Shishkoviç e Brkiç përhapen sa mundën gjuhën sllovene me anë të predikimit e të shkollës jo vetëm në Janjevë,

ku humbi gjuha shqipe, por edhe në Prizren, Shkup, Letnicë e Gjakovë. Shtjefën Gjeçovi i përkiste vëllazërisë Përgjeçaj (Prend Gjeçi) të Janjevës, një degë e fisit të vjetër Kryezezë, mjaft i përhapur në Kosovë, Pukë, Lezhë e të tjera. Autoritet fetare e regjistruan në shkollë me llagapin (mbiemrin) Gjeçoviç. Kur ai u bë i vetëdijshëm për këtë falsifikim, nuk qe në gjen-



dje të bënte më tepër, veç të hiqte atë-ic e të mbetej Gjeçov. Këmbëngulja e Shtjefën Gjeçovit për të përdorë llagapin (mbiemrin) Kryeziu, që e shohim në disa dorëshkrime si edhe në kokën e shkopit që e mbajti në dorë deri ditën e vrasjes, tregon shqetësimin e tij për të çuar në vend një të vërtetë, që ka të bëjë me kombësinë e tij thjesht shqiptare.

Kahreman Ulqini.-Dy dorëshkrime të Shtjefën Gjeçovit-Kryeziut, Etnografia shqiptare, nr. 10, viti 1981, faqe 244. Prejardhja e Gjeçovit trajtohet te “Koha e zgjetave” (koha e shigjetave) në volumnin Gjeçovi-VEPRA-3, Rilindja-Prishtinë 1985, faqe 261. Në vitin 1935 në revistën “Hylli i Dritës” ku Dom. Ndre Mjeda shkruan për Fulgens Carev O.F.M. në Dioqezën e Shkupit thotë se: “Kazarev (Carev) ishte ai që i dha shkas përhapjes së gjuhës Serbo-Kroatishite në Janjevë”. Për veç gjuhës, ata përdorën dhe liturgjinë sllave nëpërmjet dy Boshnjakve, ish fratit Shishkoviç dhe me ndonjë mësues shkollë të atij katundi e të At. Frano Brkiç. Po këtu mes të tjerave edhe disa fretenve në Shqipëri, që për emen vllazënie kishte Përgjeçaj (Prend Gjeçi) i ju zëvendësua me Gjeçoviç e Gjeçov. Pra Përgjeçaj (Prend Gjeçi) paraardhësit i Gjeçovit këtë mbiemër e kishte dhe në Janjevë. Dom. Ndre Mjeda: “Hylli I Dritës”, viti 1935, nr. 1, faqe 33-37. Në një studim për fisin

e Thaçit Paulin Zefi (Historian, Drejtor i Sektorit të Trashëgimisë Kulturore) pranë Bashkisë -Lezhë shkruan, se Prendi gëzon atributet e stërgjyshit të pinjollëve më të shquar të fisit Thaç ku bëjnë pjesë edhe paraardhësit e të madhit Fishta. Po në të njëjtin material të studimit historik për fisin e Thaçit shkruan: “Kujtojmë së At. Shtjefën Gjeçovi mbiemrin e tij të vërtetë e kishte Gjeçi dhe emrin Mëhill. Pra, Mëhill Gjeçi. Pak më lart Dom. Ndre Mjeda thotë, se nga Përgjeçaj (Përend Gjeçaj) serbo-sllavet e tjetërsuan në Gjeçoviç dhe Gjeçov. Duke u bazuar në dokumentet e më sipërme vërtetohet së edhe At’ Shtjefën Gjeçovi është fis Thaçi, i vllazënisë Prend Gjeçi të Iballës së Pukës, por dihet së kjo vëllazëri e fisit Thaç ka jetuar edhe në Kryezi. Pra, At’ Shtjefën Gjeçovi dhe At’ Gjergj Fishta janë kushërinj të një gjaku nga baba të vëllazërisë Prend Gjeçi më qendër në Iballë-Pukë. Duhet ta theksojmë se në fiset e veriut ishte traditë ruajtja e afërsisë së gjakut në breza si nga baba ashtu dhe nga nëna .Kështu, që At’ Gjergj Fishta dhe At’ Shtjefën Gjeçovi ishin dajat e Dom. Ndre Mjedës nga nëna, por është burrë Kryeziu (i biri i Kolë Zefit, Kryeziut dhe Luke Thaçit të Iballës). Pra Dom Ndre Mjeda e dinte shumë mirë origjinën e Gjeçovit, se ishte nga vllazënia e Prend Gjeçit të Thaçit Iballës.

Çdo manipulim i huaj apo vendas nuk i shërben dimensioneve të këtyre kolosëve të kulturës dhe patriotizmit mbarë nacional shqiptar, përkundrazi i dëmton të vërtetat për këto figura. At’ Gjeçovi lindi në Janjevë, më 12 korrik 1874, ku mbaroj 3 (tre) vite shkollë. Në kolegjin françeskan në Shkodër, ku u paraqit e dërguan në kolegjin françeskan në Trashan të Lezhës, për të vazhduar mësimet ku dhe i mbaroj. Në vitin 1888 vazhdoi studimet në Bosnjë dhe Kroaci (këtu studio për teologji dhe filozofi). Shërbeu si famullitar në Laç të Kurbinit, Troshan, Gomsiqe e Gojan, Theth të Shalës dhe Prekal, por shërbeu dhe në Pejë, Gjakovë e Prizren. Gjithashtu edhe në Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Zarë të Kroacisë. Ai ishte patriot (pjesëmarrës në luftën e Vlorës, në vitin 1920) shkrimtar, etnolog dhe arkeolog, përkthyes, klerik, dramaturg, mësues i popullit, novelist, përhapës i shkollimit shqip. Kanuni mbetet kryevepra e tij.

Laurimet:

1. At’ Shtjefën Gjeçovi është nderuar me “Medalja e Artë e Lidhjes së Prizrenit” në Kosovë.

2.”Monument i At Shtjefen Gjeçovit”.

Për veprimtarinë e tij etnografike dhe arkeologjike brenda dhe jashtë atdheut Universiteti i Lajpcigut të Gjermanisë i dha titullin “Doctor Honoris Cauza”.

Në Shqipëri për veprimtarinë e tij patriotikë dekorohet më urdhrin “Naim Frashëri” të klasit të parë. (F. E. SH.) Tiranë 2008, faqe 814.

Më 14 tetor 1929 në Zym të Kosovës nga një atentat serbo-sllav At Gjeçovi vritet. Në të vërtetë ai ndërroj jetë por se, veprimtaria e tij patriotike, dashuria për atdhe, për pavarësi, për shkollim, dije dhe kulturë, studimet e tij bashkëkohore dhe në lashtësi e bëjnë “TEMPULL” më vete, që nuk e lënë të vdesin kurrë.

ABAZ BEKTESHI, SHKROI NJI REFREN TË RI NË EPOSIN HEROIK TË SHKODRËS

Tregim nga **PRELË MILANI**
(Vijon nga numri i kaluar)

Malësorët prej kreshtave qiell-prekëse, kur panë zbythjen e Gaziut me shellek solem, shprazën breshëri pushkësh në shenjë ngazëllimi.

Prijësi i klanit të ujqve gri i vuni majën nga i pat vu thembrën, shkapërceu Drinin, doli në Pukë e vrapoi drejt Shkodrës tue çue për hava mjegull e tym tmerri. Ndonëse bishtvarun atij i printe fama e heroit. Në Shkodër u hap lajmi me tellall, se fitimtari i plotfuqishëm po vinte triumfalisht në kryeqytetin e Vilajetit Verior.

Kapot fanatik të shehrit, të majmur në çifliqe dhe ofiqe otomane nxorën lajmin, që u përhap si era se Turgut Gazi Pashës do t'i bahej shumë qefi po të dilni e ta presni:

Te ura e Bahçallëkut dolën kryetarët e klaneve ma të fuqishme veshun me rrobat ma të bukura e ma të shtrenjta. Veç të shihje. Ishte një paradë spektakolare kostumografije. Mbizotëronin xhamadanat dykapakësh me fije arit, me mangë të gjata të qepuna në copë të kuqe të ndezun mbingarkuar me sumbulla ari e argjendi pune me filigrane fine. Fesi "Tanës" me ngjyrë të kuqe, me tufë të mëndafshhtë bluë që zbriste në shpinë, tregonte zotnillekun e mbartësve. Kalldrëmi gumëzhinte nga pafat e këpucëve të kuqe me llapë e maje të rumbullakët.

Në silahet prej lëkure të mbërthyer mbi shokat me vija, vareshin armët hijeranda të lara në argjend...

-Ku po shkon, more bir: - e pyeti tata Abaz Bekteshin?

-Po dal e shoh prej seri ç'ka drejt asht ky Turgut Pasha!

Nuk i ka ra gjuha në gojë qysh dje tellallit tu thirrë;

- Dilni se erdhi "shpëtimtari".

-Abaz, na jena zejtarë dembabadem, shohim punën tonë e bereqavërs duhet me thanë.

Kush vjen e kush shkon nuk na duhet gja. Politika asht fajde, por si njana si tjetra të hanë kryet:

Abaz Bekteshi ishte dyfekxhi duarartë, djalë i pashëm, fjalëpak, as nuk nguete as nuk duronte njeri.

Në dugajë punonte bashkë me të atin. Kohët e fundit porosite ishin dy a trefishuar

Në malësi kishte shumë myshteri, të cilët i kishin kallëzue për mësymjen

e Turgut Pashës.

Dy ditë ma parë, një myshteri që erdhi me riparue manzerin i tregoi lajmin e hidhur të vrasjes së Marash Tomës. Abazit iu duk sikur iu shemb tavani e i ra në krye.

-Aiii ç'ka fole bre; - i tha bashkëbiseduesit. Zemra i tronditi gjoksin dhe kjau me lot për faqe.

-Ju thaftë dora kush ia ka vu pushkën atij farë djali!

- Po besa, more mjeshtër, nuk kish lokja tjetër.

-Jena njohë prej kohësh, ishte djalë i squet trim dhe i fjalës, e patëm vendosë me u probatinue.

Në vjeshtë patëm nda cakun e pimjës së gjakut, por nuk paska këne kismet!

-Lufta kjoftë mallkue!

-Amanet si e vranë Marash vëllanë?

-Mos o Zot ma keq, gjithkund jeton fara e të keqit dhe e tradhtarit.

-Mbas një jave qëndresë në hyrje të katundit, na u mbaruan fishekët dhe baruti. Pasha nxori faljën, po qe se dorëzonin armët. Marashi shkoi dhe dorëzoi një pushkë, ndërsa një martinë që e kishte për shumë marak e fshehu në zguer të manit që kishte në oborr.

-Po, besa bash martina që ia kam zbukurue me filigrane unë!

- Sadri Zekës i kshenë i pakryq e i pabesë kur i kërkuan me dorëzue armët tha:

-Zotni Kapiten, për ç' arsye merrni armët te unë, kurse komshiut Marash Tomës ja leni?!

-Po ku i mban armët ai qafir; - pyeti komunari.

-Në oborr të shpisë në zguer të manit, - foli hafija. Kapiteni shkoi dhe e gjeti armën dhe e pushkatoi Marashin e shkretë.

- Pastë faqen e zezë! E laftë me kaptinë atë tradhti të fliqun!

-Gjithkush e ka ndie, ia ka shkruet faqën e zezë.

-A kanë pas ndonjë hasmëri apo armiqësi të vjetër se nuk ka qysh shitet komshia te turku i Anadollit?

-Besa ma keq nuk ka. Sadria ka një grue fort të bukur, edhe asht ba vezëve se ia ka puthë Marashi....

Thirrja e tellallit ia ndërpreu filin e mendimeve Abazit

-Babë, unë tash po dal dhe nuk vonohëm. Shëndosh me kenë, se punën që kam në dorë ta përfundoj sonte.

-Po e shoh se tu ka pingalez dhe je

veshë me takëmët ma të mira.

Po ato lule për ç'ka i ke?

-Asht ditë e veçantë sot. Po parakalon Gazi Pasha, ishalla kam fat me ia dhurue një buqetë

- Ti je zejtar, more bir e të takon rralla vonë. Eh sa dai e dallkauk ka para teje.

-E more tatë, një herë të bjen zogu në dorë. Nesër ka me thanë tanë Shkodra se djali i Rustem Bekteshit i dha lule gjeneralit, ma të zotit të Rummelisë!

-Pritna Zot sherrin e tij, biro; - tha tata ndërsa Abazi fluturoi për te ura e Bahçallëkut.

Në radhë të parë ishin paria krenare. Mbrapa, në periferi zu vend Abazi mes disa të rinjëve soditës.

"Heroi i dashtun" ia mbërriti i hipur mbi një pelë të shkëlqyeshme arabe që tundte krifën e kuqe. Erdhi i vrantë si reja dhe zjarrtë si dielli përvëlues i atij fund korriku. Nji tufë e madhe shoqnuesish dhe bashkëluftëtarësh i vinin pas si vagonat pas lokomotivës. Trupa dukej e lodhur nga rruga, vapa e jashtëzakonshme dhe etja. Pamja e tyre me fytyra të parrueme, të nxime prej diellit e të pluhrosuna nuk i kënaqi mikpritësit krenarë që kishin dalë për të parë suitën elitare jo një detachment fatkeq.

Në anën tjetër Gaziu, i befusuar nga kjo përulje e shpifur shfyru me vete.

-Ahhhh këta servilë mjeranë, shpirta të ligj! Batakçi krenarë paskan dalë të më presin në revistë. Mjerë për ju dhe yllin tuaj të turpëruar! Gaziu, i lënduar prej grushteve dërmuese që kish marrë ndër male, por edhe për shkak të lodhjes, dhe natyrës së tij tekanjoze shpërtheu në rrufe kërcenuese

-Si mund të ngriheni kaq krenarë, sa të dilni të m' takoni të armatosun? Këtu nuk merret vesh se kush asht gjenerali, unë apo ju që më kapardiseni me armë të argjendta e petka të lara në arë.

Si mund të jeni kaq kryelartë sa dilni të armatosun të përqafoni atë që Stambolli ka çuar t'ju çarmatosë?. Për sa çerekun e armëve tuaja që demonstroi gjithë salltanet ka bombarduar e djegë flakë malet. Abazi tu pa heshtjën memeece të parikëvë avancoi në rreshtin e parë me një tufë karafilash flakë të kuq e tha:

-I lavdishëm Gazi Pasha, asht një ditë e shenjtë për ne që një përfaqësues

kaq i naltë i Sulltanit të madh, që vjen në qytetin tonë. Për ne do ish mungesë respekti po të mos e banim këtë pritje që meriton shkëlqesia juaj! Armët tona janë në shërbimin tand, ndërsa lulet si shenjë mirënjohje për triumfet tua.

-Ç'ka asht ky lapec që lot teatro, -tha Turguti e u bani me shenjë truprojave të tij?

Asqeria u vërsulën si ujkit ndër dele mbi parinë e zgjedhur të Shkodrës, tu e goditë brutalisht me grush-ta, shkelma e kamxhik. Si re e zezë Podgorice që zë peshkatarët në mes të liqenit shpërtheu shtrëngata aziatike. Zotnitë fluturuan me nallça përpjetë, dikujt i valonte gjaku për hundësh, të tjerë të kopatur nga kamxhiku për gjatë shpinës me zor mbusheshin me frymë. Po thuaj as kush nuk mbeti pa një nishan në fytyrë apo dremitje në stomak apo organet gjenitale. Patllaket dhe taganët e stolisur u ranë për tokë dhe i dorëzuan pa kurrfarë nderi:

Abaz Bekteshit i luajti terezia

- Jazek, . Qysh rrahët burri me armë në brez kësaj i thonë;

- E mbajsh me marre!

I gjendur si shkëmbi mes valëve ju kujtua Kaçaniku, Cernaleva-Sh-timilja. Guri i Paçit, Qafa e Agrit dhe probatini që iu fik vatra me gjak. Hodhi lulet e fluturim si zana nxori prej brezi rrakelën dorezën e së cilës e kishte mbështjellë me një shami dhe ia drejtoi Pashës në gjoks. I ngrehi gisht, por medet se nuk qe e shkrueme me marrë flakë baroti. Në nxitim e sipër Abazi bashkë me revolen nxori edhe shaminë, cepi i së cilës për ters hyni mes ullukut të çarkut dhe grykës, tu pengu goditje e kapsollës prej thumbit shkrepës. Sado që ia shkeli gishtin e gackeqës edhe gjashtë herë arma nuk mori zjarr. Truprojat u hodhën mbi Abazin me ba copë-copë, por Turguti si kalorsiak i vjetër që ishte bërtiti rreptësishtë.

- Mos e prekni me dorë ! Burrat të k' tillë nuk shnderohen me kamxhik! Kismetit ishte me mue jo me atë trim. Shkodra si çdo organizëm ka jashtëqitjet e veta, marrën e ketyne shqiptarëve pa ndjenja dhe gjak arb-nor e lau koburja e Abaz Bekteshit, i cili shkroi një refren të ri në eposin heroik të Shkodrës.

VAJTIMI I VAT DASHIT PREJ THETHIT, 1931

Kur e njeva i za prej serit,
Than asht vra Vat Dashi i Thethit.
Vat, o Vat, o koço Vat,
Se unë nuk mundem për me t'kajjtë,
Se unë nuk mundem me t'kajjtë ty,
Nuk ka grue si t'kjanë n'malësi.
Ty t'kajnë zoja e zotni,
Edhe t'kajnë Krajlrat në Krajli,
Dhe të kjanë ky mreti i ri,
Që asht vu përmbi Shqipni,
Se kur ka nije mbreti për ty,
Tri dit kafen se ka pij,
Një tri ditë pa dal n'ushtri,
Ka kthye teshat me t'mbajjtë zi,
Se je kë në një djalë i ri,
Vesh e mbathë për bukuri,
S'ke pasë shoq në shtatëqind shpi.
Tirqit qepun në terzi,
S'i kanë pasi kuj hije si ty,
Shputët qendisun në malci,
Shokën njesh si lahuri,
Nji mitan-jelek për mij,
Shall mnashit, kapuçin mbi sy,
Rrethin njesh plot me fishekë,
N'krah manxerren suhareshë,
Vjerr sahatin në qystek,
Besa besë, tha, e kam pa vetë,
Ke pasë alltinë në vargua.
Tybe Vat të kanë hetua,
Qasaj rrugë që je fillua,
Ma mirë Vat t'ishe dredhua,
Se pesë prita t'paskan rrethua,
Te tanë shtatin ta kan mirua,

Zemrën tanë e kanë coptua.
Ke lutë zotin me të nimua,
Boll mirë shtatin ta ka forcua,
Ke dredh, pushkë i ke gjua,
Pesë fish veten e ke pagua,
Tre vra dekun e dy varrua,
E tan Shalën e ke nerua.
N'atë pyll si je metë,
Janë ardhë roptë e të kanë gjetë,
Arm' e petka ti kanë hjekë,
T'i kanë çue në shpi t'vet.
T'kanë shti n'dhe n'bregdet' t'gjanë,
Tu t'përvlohet kama n'opangë,
Tu thahet gjethi n'lamë,
Tu piqet voja në ranë,
Të kanë shti n'dhe në ato dhoma,
Ku përpiqen toksi e bolla,
Ti kujton se i ke motra,
Nuk janë motra me të gzue,
Toksi e bolla me të qorrue,
Por ti s'ke dorë për me i pritë,
As nuk ke kamë për me ikë,
As nuk ke gojë me bertitë.
Çudë po m'vjen për lesh t'ktij oqiçi,
Si e paska leshin prej mnashit,
Edhe mishin tanë prej vjemit.
Ishe djalë prej derës çobanit,
Ja çon daja nipit prej mallit.
Kam një fjalë me t'shoqet e Vat Dashit,
Se në kjossh bijë oxhakut,
Shtjerja krahët atij konakut,
Banu nana e ktijë vatanit.
Ne paç mendjen fëmijët me'i lanë,

Bjeru shplakë, qiti m'njan anë,
Mos i le me të thirrë nanë,
Edhe drita k'tu mos me t'zanë.
Ti në daç me rritë jetima,
Hiqe rrypin e telatinit,
Njesha barkun me balqa t'dhinta,
Ke me mathë çakçirë e t'lina,
Math opangët me sinxhira,
Kamë për kamë me shkue me trima.
Kam kajjtë boll he mu thaftë goja,
I ke kunetnit si sokola,
Ke dy djem sikur dy madha,
Si nju kapsh Pjetrit për fytit,
Sikur ferra n'lesh t'ogjiçit,
Si nju kapsh Lulashit g'junit,
Si i toksi për rreth gurit.
Kam kajjtë boll, e kam teprua,
Ka ardhë vakti petkat me i çua,
Për Vat Dashin ma mos me i bashkua.
Na po biem për shteg t'oborrit,
Për t'mirë t'ardhshim mas sodit.
E kam një zi për djem t'konopit,
Babun Celi ish kë në prej Shoshit,
Babun Celi e shoktë e tij,
Tybe m'kjoftë emnin s'jau di,
Për Lush Prelën kam nije zi,
Thonë e preu krajli n'Serbi,
Fike zot trollin e tij.

Vajtue nga Bojë Lucja
nga Malësia e Madhe,
shtator, 1931



Vat Dashi, 1917

FLASIN KAMPIONET ARBËN SHYTANI, TEK DJELMIA SHKODRANE NDJEHEM SHUMË I MOTIVUR

Kampionatet e Ligës Amatore janë mbyllur pak ditë më parë dhe në fund të tyre janë kurorëzuar edhe më të mirët. Kuptohet që marrja e një kupe, medalje apo diplomë, është një kënaqësi shumë e madhe sepse konsiderohet kurorëzimi me sukses i mundit të një viti të tërë. “Shkodra Sport” do sjell pranë jush profilet e pesë trajnerëve të ekipeve kampione të këtij sezoni. E nisim sot, me atë të Arber Shytani, trajnerit të ekipit “Djelmnia shkodrane” që u kurorëzua kampion i grupmoshës U17. Ndiqni më poshtë bashkëbisedimin e bërë me te, për gazetën tonë: **Arber, çfarë do të thotë të jesh trajner kampion?**

Nuk kam pse të bëj modestin, ky titull kampion i fituar sigurisht që më ka dhuruar kënaqësi të madhe. Eshte viti i dyte që e drejtoj kete ekip dhe perpos suksesit, jam shumë i kënaqur, sepse më duket se kam filluar të merrem vesh mirë me lojtaret.

Me këtë grupmoshë sezonin e ardhshëm do të marrim pjesë në kategorinë e parë. Kënaqësia nuk është thjesht se u renditëm në fund të kampionatit në vendin e parë, por sepse treguam një performancë shumë të mirë gjatë gjithë sezonit dhe dominuam ndaj të gjithë ekipeve. Këtë e tregojnë edhe shifrat, kemi shënu-

ar 115 gola, diferenca me vednin e dytë ka qenë 15 pikë dhe këto rezultate nuk mund të arrihen nëse ekipi nuk di të luajë bukur futboll. Prandaj dhe unë jam shumë i kënaqur me gjithë ecurinë që ka pasur ekipi

Dhe diçka shumë pozitive është se 90 për qind e grupit të lojtarëve do të jetë sërish në dispozicionin tim, ngaqë sivjet kanë luajtur me një datëlindje më të vogël dhe do të kenë mundësi të luajnë edhe sezonin tjetër. Objektivi nuk do të jetë thjesht sa për të marrë pjesë, por do të kemi synime të qarta për të marrë maksimi-

mum e mundshëm.

Përfaqësoni një Akademi si ajo “Djelmnia shkodrane”, e cila sidomos dy vitet e fundit po e thotë dukshëm fjalën e saj në futbollin e moshave në Shkodër. Çfarë është kjo Akademi?

Akademia “Djelmnia shkodrane” ka ardhur duke e marrë konfigurimin e saj të plotë sepse kemi ekipe për çdo grupmoshë dhe secili ka trajnerin e vet, kemi trajner të përgatitjes atletike dhe trajner portierësh. Por jo vetëm kaq. Fakti që nga Akademia jonë tashmë ka lojtarë edhe në ekipet kombëtare, është një sukses.



Gjorgjino Zhuja është pjesë e rëndësishme jo vetëm e kombëtares rajonale, por edhe e kombëtares së madhe për këtë grupmoshë, Aldo Nika është pjesë e kombëtares U17 dhe ne shpresojmë që në të ardhmen të kemi edhe më shumë lojtarë në këto ekipe, ashtu siç ka qenë më parë edhe Klaudio Narkaj e ndonjë tjetër.

Punën tonë na e ka lehtësuar shumë presidenti Benardin Kulla, sepse duhet të dini që në Akademinë tonë futbolistët kanë pagesa minimale për të bërë, ndërkohë që tek ekipi U17 nuk kanë pagesa fare, sepse ato mbulohe nga presidenti. Përpos të gjitha këtyre, në sezonin e ri, Akademia jonë do të ketë në dispozicion dy fusha stërvitje dhe ato në kushte shumë të mira, duke qenë besoj Akademia më e plotësuar në këtë drejtim. Dhe kur investohet në infrastrukturë, kur investohet në burime njerëzore, atëherë nëse nuk ke rezultate, sigurisht që përgjegjësia do të bie mbi ne.

Cilat janë planet për të ardhmen tuaj?

Jam duke e bërë me shumë dëshirë këtë punë dhe tek “Djelmnia shkodrane” ndjehem mirë. Më 1 gusht besoj se do të rinisë puna dhe po ashtu do të riformatohen ekipet dhe me siguri që ambicjet për të bërë mirë do të jenë edhe më të mëdha. Fakti që do të kemi në dispozicion terrenet më të mira sportive aktualisht në Shkodër, do të na ndihmojë për ta bërë edhe mirë punën tonë.

Bashkëbisedoi Gjergj Kola,
gazetar sportiv te TV “Rozafa”

*** POEZI *** ** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI



Piktori e poeti
Idriz Berisha - Xhixhi, Klinë

TROKU APOKALIPTIK

(Dërguar nga gjuhë covid19)

Zjarr që lule e tokë djeg
amfitetër i kuq
shfaqje apsurde pa fjalë
nis marsit e verës tutje
thanë lulevere
Planetin nxinë me lot valë.

Statujat do mbijnë bulevardeve
Pa frigë e të qeshura
Do ketë dhe këngë e vaje
Sheolit do i hapën çepengat
Do vije dhe aromë njeriu
me parfume nga mbarë bota
Vdekjes t'i rrijmë gaditu.
Emblemë si diell i kuq me gjemba
Frigë ndjell
Flamuj djeg!
Apokalips si pikturë Dyreri
me shpirtra t'përflakur
Një ditë
edhe vdekja do të vdes majë Olimpi
botë tjetër në një çast
do rilind krejt e bardhë!

KAH PO VJEN KY ZË

Fluturim nëpër rrugë pluhërosura
që askush si lanë
që askush si qanë.
Janë klithje kontinentesh
zëra të mpleksur koridorëve
si kalorës me shpata
Vdektar të gjallë kërkujnë.
Dje kishte njerëz këtu
Ç'u bënë a thua!?

Dhe shi binte dje, kush e thau
konvertim në Armagedon profetik
që horizonteve shpresat mbledh
si zogu thërmitë
e si nëna fëmijë
skutave të globit maskuar
pendim nërresirë për t'kërkuar
Po po
qyteteve të largëta Metropolis.

KUR YJËT NDIZËN

Nata s'u ngrohu ashtin e mërdhirë
as dielli lotin s'u thau
veç toka e qielli i pau.
Duartë të zbehta që zgjatën
si hije në ujë që dridhën,
ai zë foshnje me flutur mbi ballë
ai tjetri me lulekuqe në dorë
dhe këta zogj të hudhur mbi lum
grykave që jetën përpinë
Po,
Ecjet si në teh shpatash
me lindjevdekje nëpër natë
Në mungesë të vetëvehtës
në një natë të errët
secili u bë mbret
secili foli vet
secili u bë zjarr
Në cep nate me ëndrra të vrara
ra perdja si në teatër gërmadhash
me ngjyra të dritëzuara si dje.

TOKË E BARDHË

Kjo tokë e bardhë
Eh tokë e bardhë
me vija të kuqe gjak
sa gur mbanë në gjij!

Të ti Gjergji pushoj trupin
dhe kokën pushoj Gjergji,
shkëmbi ju bë shtrat
fjala i mbeti shpatë!
Mburojë e plumbt mbi shpatulla
histori që rrjwdh damarëve.
Ah tokë e bardhë
Tokë e bardhë
duan të me shkulin nga ti
e nga fryma jote
Dua kalldrëmeve tu [të ec](#)
po rrugën w kam me zgavra
dua të të prek Gjeneral
po koka jote është të qielli
mbeta rob i gjakut tënd.
Ah tokë e bardhë tokë e bardhë
Të ka hije vija e kuqe
të ka hije dhe shpata
Nëntorëve lind nga një Gjergj
tokës së bardhë Skënderbe!

DRITË SI DRITË AGIMI

Hjynisht të shfaq dashuri
e trishtimin ma hoqe qafe
faleminderit Nënëmadhe
për zërin tënd qiellor
Gonxe e kopshtit tonë!
Prita e prita
bulëzimet e përmotshme
acarëve me bark të zbrazët
vetmia më mbështjell e me ngroh
me duartë tua rrudha-rrudha
njëzetekatër orë në ditë

me bëhësh shpresë Nanëmadhe Tereza
dhe fanar netëve pa hënë
Po,
Sari yt i bardhë si shpirti yt
Lartësive u jep dritë
si emri që shëron
dashurisht Shën Tereza jonë!

TJETËR KOHË

Ate ditë
mund të mos jemë,
edhe mund bjerë shi
ate ditë
mbi flikun tënd të zi.
Tjetër kohë
e tjetër mot mund jetë
mbi valët e valëzuara kur ti s'je
vargje mund shkruaj
në milenium të ri me kujtime të vjetra
tjetër kush mund të vijë
Frik me zemër prush
flas me lumin e i thëm
Trembi vargjet mes dallgësh
as hijen mbi lum të mos e shoh
Nuk vlenë as dhurata qiellore
pa ty e këngën e lënë përgjysmë
së kohën ma këtheve përmbys
do e bëjë mozaik për mur antik.

SHIU I VERËS

Nëse heshtas ke hy
nën ombrellën time
do të bartë nga një ujvarë tek tjetra,
Emrin s'ta mësova
po zërin t'a njoha.
Tingujt e hapave tu
pranga me bëhën e mure
orakull dashurie mbi ballë
peshë malesh mbi shpinë
kjo rrugë deri në takim
eklipsohet, me xhemba bëhet
Ombrellën
dhe na e marrt ylberi
qepallat tua si lag shiu
as si thanë
as si lanë
Zjarr i pashuar do mbetët
metropoleve harruar mërgimtar.
Sa shi do bije
mbi lumin tonë vërshues .

LETËR PIKTORIT

I thash piktorit
më bëj një qiell tjetër,
një qiell të ri m'a bëj
në mes syve tu blu
një peizazh pa fund
që tokën t'a puth pranverave
të lumi i bardhë mbi Pejë
ku dashuritë
zbardhajnë për vjet.
I thash piktorit
ma bëj një zog shtegtar
pranverave lajmëtar.
I thash piktorit
ma bëj një flutur
me krah ngjyra -ngjyra,
lulet t'mi numëron
e pikat e shiut, ti hedh mbi lum
T'ma bëj një pikturë

me emrin tënd t'vonuar.

KUFIJTË E DASHURISË

Kur dashurinë t'a njohësh
qoft edhe në Luvër,
mes Monalizës dhe diellit
kënd do t'a zgjedhësh?!
Aty,
të Pasarelat e artist
duartë kryqëzua nga frymëzimi
pa kufi as pa gurë
filluam një pikturë.
Dielli mori ngjyrë molle
e dritarët e bardha u bënë me harqe
përpijnë muzat e kohëve
me Leonardon e Monalizën
shndërruar në hyjneshë arti
në kopshtin e rilindjes
ku harron dhe të marrësh frymë
aty të Champs Elisse
Janë kufijtë e dashurisë.

KLITHMË ANTIKE

Mjegull ,agullimë maje Olympi
si avuj puthjesh heshtake
britmë e klithje antike
mbi tempujt e lashtë t'perëndive.

Honeve symbyllazi kalërova
me porta të mbyllura mbi shpindë
e kush s'pat ti hap
as t'u vejë flakë.
Refrene dhembjesh çdo ditë
vdekjet matën me lindjet
të votrat ku akujt shkrinë
Jam këtu të ky gur i braktisur
nga ku këmbë njeriu nuk shkel
Hej!
ec e ec e ec e ec
pa gjetë as kapth mali
as ferkëm kali
Shpalos tokën palë palë
thellësive u prek damarë.
Jam këtu e këtu do vdes.

PLIS SI DRITË

Këto bardhësi motësh
edhe dielli lakmon
Kurorë bjeshkësh e malësh
PLIS e DRITË
DRITË E PLIS
mbi kokë Zeusi, shekuj zbardhon
në ditë e dritë stinësh
në kolona darsmorësh.
Hije u bëre, dritë u bëre
plis i bardhë-borë e bardhë
të ruajtëm siç ruhet Zoti
me emër që pat moti
në kulla guri i kuq Flamuri
Plis e dritë, betuar mbi Ty
bukuri që hijeshon
Iliri e Dardani
Zeus, zot i plisit tonë n'Dodonë.
Emrin e ke plis, mbiemrin i bardhë
je në kokë, mbi sy, në ballë
dhe kokën po ma hoqën
Ty s'të heq o Plis i Bardhë.

Klinë, 20.korrik 2020

Të dashur lexues të gazetës “Dukagjini”!

Nga sot do të hapet një rubrike e re në gazetën “Dukagjini”, “Këndi i fotografisë”, në të cilën do të publikojmë foto të përzgjedhura të periudhave të ndryshme. Janë të preferuara foto sa më të vjetra dhe sa më masive, foto panoramike, portrete, momente të veçantë, bardh e zi dhe me ngjyra. Në të gjitha fotot, synojmë, që të paraqitet dhe propagandohet sa më shumë jeta dhe puna në Dukagjin në të gjitha periudhat.

Fotot e vjetra, të radha dhe shumë të radha do të kenë përparësi në publikimin e tyre. Çdo foto duhet të kenë të dhanë për vitin, personi ose personat mundësisht, dhe vendi i fotografimit.

Ju ftojme që të bëheni pjesë e pasurimit të gazetës tonë.

Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"
Redaksia e gazetës.



Grupi artistik Shosh 1984



Marash Ndue Dreni instrumentist i talentuar i disa veglave muzikore popullore



Marjan Prela me nxenes dhe prinder ne vitin 1921 ne Theth



Grupi artistik i Planit në Breglumi-Shalë

REDAKSIA

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI

Redaktorë: Suela Ndoja, Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Kole Çardaku, Eilda Delija, Age Martini, Klodiana Serraj, Vilson Peshkaj, Marijan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza e Ndue Ziçi.

Mundësoi Botimin:
AGRON HASANAJ

